

GNATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T I
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 27. 8. 2007

T R A N S K R I P T
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 27. 08. 2007. GODINE

GUSHT – AVGUST 2007

R E N D I I D I T Ě S

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 27 e 31 dhe më 30 korrik 2007;
2. Koha për pyetje parlamentare;
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët, nr. 2003/11;
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organizimin e institucioneve të Kadastrit;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis;
6. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2006;
7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për bartjen e mjeteve buxhetore të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2007;
8. Shqyrtimi i Projektrezolutës për KXM “Trepça” të propozuar nga Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Miniera, Transport dhe Telekomunikacion;
9. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me propozimin e Prokurorisë Publike të Kosovës për emërimin e një anëtarë në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

D N E V N I R E D

1. Usvajanje zapisnika sa plenarnih sednica od 27 i 31 i 30 jula 2007. godine;
2. Vreme za poslanička pitanja;
3. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o putevima;
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o organizaciji institucije katastra;
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o proceni uticaja u životnoj sredini;
6. Razmatranje izveštaja Kancelarije regulatora energije za 2006. godinu;
7. Razmatranje preporuke Komisije za budžet i finansije o prenošenju budžetskih sredstava Kancelarije regulatora energije za 2007. godinu;
8. Razmatranje Nacrta rezolucije o RMK „Trepča“, predložene od strane Komisije za privredu, trgovinu industriju, rudarstvo, transport i telekomunikacije;
9. Razmatranje preporuke Komisije za pitanja pravosuđa, zakonodavstva i Ustavnog okvira u vezi sa predlogom Javnog tužilaštva Kosova o imenovanju jednog člana Upravnog odbora Sudskog instituta Kosova.

A G E N D A

1. Approval of the minutes of the plenary session of dates 27, 30 and 31 July 2007;
2. Time for parliamentary question;
3. The first discussion of Draft Law for amendments and additions of the Law on Roads, no. 2003/11;
4. The first discussion of Draft Law in organizing of Cadastre Institutions ;
5. The first discussion of Draft Law on Environment Impact Assessment ;
6. Discussion of the report of the Energy Regulatory Office for year 2006;
7. Discussion of the recommendation of the Committee for Budget and Finance for carrying forward the budget means of the Energy Regulatory Office for year 2007;
8. Discussion of Draft Resolution for KXM “Trepca” proposed by the Committee for Economy, Trade, Industry, Mines, Transport and Telecommunication.
9. Discussion of recommendation of Committee for Legislative matters, Judicial and Constitutional Framework regarding the proposal of Public prosecutor’s office for appointing a member in the Steering Committee of the Judicial Institution of Kosova.

KRYETARI I KUVENDIT Të KOSOVËS, **KOLË BERISHA** – Të nderuar deputetë, Kryeministër, ministra dhe Kabinet qeveritar, mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës!

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 65 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën. Që në fillim ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 6.2 dhe Rregullën 23 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe i ka prezantuar Kuvendit rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Miniera dhe Transport rezervon të drejtën që më vonë të paraqitet lidhur me rendin e ditës

Urdhëroni, zonja Gaxherri!

BESA GAXHERRI – Faleminderit, zoti Kryetar!
Kolegë deputetë,

Në lidhje me rendin e ditës, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, kam një propozim.

Duke pasur parasysh që ky Kuvend nuk ka mund të aprovojë qoftë edhe një ligj për Presidentin dhe Memorialin e tij, Presidentin historik të Kosovës, dr. Ibrahim Rugovën, ne sot propozojmë që ky Kuvend ta nxjerrë një vendim, së paku në shenjë respekti për jetën dhe veprën e tij, që fotografia e tij të bartet në institucionet e Kosovës si dhe në institucionet publike. Duke pasur parasysh që ky President është zgjedhur President i këtij populli për tri etapa historike, atë të paraluftës, gjatë luftës dhe pas luftës. Për të mos e polemizuar këtë çështje, ju zoti Kryetar dhe Kryetari Sejdiu jeni të njoftuar pikërisht me problemin që unë po e ngris. Këtë dua ta them për arsye se nuk dua që kjo t'i përngjajë fushatës politike, por vërtet personaliteti i Presidentit Rugova nga njerëzit e caktuar mendohet të nëpërkëmbet. Andaj, sot ky Kuvend propozoj që të nxjerr në votim një vendim në shenjë të respektit për veprën dhe jetën e tij. Pra, Kuvendi të nxjerr vendim që të gjitha institucionet e Kosovës dhe ato publike të bartin me respekt portretin e Presidentit Rugova.

Unë i ftoj të gjithë deputetët që të votojnë për këtë propozim, që të shkojë si vendim duke pasur parasysh se meriton të respektohet. Të shtoj se edhe me rastin e vdekjes së tij u pa që i gjithë populli i Kosovës kishte një respekt për Presidentin historik të Kosovës. Faleminderit, dhe kërkoj që ky propozim të vihet në votim!

KRYETARI KOLË BERISHA – Propozimi duhet të shkojë në procedurë të rregullt, sipas Rregullores së Punës.
Urdhëroni, Gjergj!

GJERGJ DEDAJ – Faleminderit shumë, zoti Kryetar!
I nderuari Kryeministër,
Ministra, kolegë deputetë,

(Ndërhyrje e kryetarit)

KRYETARI KOLË BERISHA – Rreth rendit të ditës, po!

GJERGJ DEDAJ – Po, ngadalë se ende s’e di. Ku po ma lexon trurin kaq shpejt se çka po dua të them, zoti Kryetar?

KRYETARI KOLË BERISHA – Po t’i sigurisht s’e e ke përcaktuar për çka.

GJERGJ DEDAJ – Shiko Kryetar, nëse s’ke dëshirë që unë të flas, s’po flas, po ta bëj qejfin.

KRYETARI KOLË BERISHA – Unë ta dhashë fjalën, po dua ta di.

GJERGJ DEDAJ – Mos më ndërhyjë, Kryetar, se nuk është e ndershme aspak, për besë. Unë desha ta shtroj një shqetësim që është shumë i rëndësishëm për të ardhmen e vendit të Kosovës e që më së paku ose asnjëherë s’po e përmend ky Kuvend i Kosovës. Çështja është për zgjedhjet. Tashmë një muaj a dy nëpër gazeta po lexojmë ne 13 partitë e tjera që nuk jemi të përfaqësuar në Ekipin Negociator, që po donë të mbahen një palë zgjedhjesh brenda dy muajve dhe kam dëshirë që ky Kuvend, që është prodhim i zgjedhjeve, produkt i zgjedhjeve të vitit 2004, dhe çdo Kuvend është, do me thënë kalon nga një proces zgjedhor, që të merret pak më seriozisht, të na informoni ju, zoti Kryetar, për zgjedhjet, sepse përveç 4 partive në Grupin Negociator, janë edhe 13 parti të tjera, por janë edhe përfaqësuesit e bashkësive të tjera etnike të cilët mendoj se fare nuk janë të informuar, asgjë nuk dinë se çka po bëhet me këto zgjedhje dhe për zgjedhjet, edhe pse ne mendojmë se prioritet duhet dhënë statusit e pastaj të merremi me çështjen e zgjedhjeve. Kam dëshirë dhe të lus zoti Kryetar që ...(ndërprerje).

KRYETARI KOLË BERISHA – Shkojmë me pikën e parë të rendit të ditës.
Urdhëro, Ramadan!

RAMADAN KELMENDI – I nderuari Kryetar,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Deputetë të respektuar,

Në seancën e fundit të këtij Kuvendi është debatuar lidhur me ndërtimet ilegale të banesave kolektive, të investuara nga Qeveria e Serbisë në Veriun e Kosovës. Për këtë çështje, fatkeqësisht, ka munguar kuorumi në fund të seancës dhe për mungesë secili le ta bartë përgjegjësinë e vet. Është vendosur që sot të jetë në rend dite pika e miratimit të rekomandimeve lidhur me këtë çështje. Andaj, mbështetur në atë që u diskutua, ju lutemi që ta veni në rend të ditës këtë çështje dhe të miratojmë rekomandimet e propozuara nga Grupi Parlamentar i LDD-së, gjegjësisht parashtruesi i debatit, ose është vendosur që të formohet një grup për t’i shqyrtuar dhe për të dalë sot me rekomandime. Këtë çështje e kam ngritur edhe në ...(ndërprerje).

KRYETARI KOLË BERISHA – Zoti Kelmendi, është dashur të paraqitet kjo me shkrim.
Vazhdojmë më tutje.

- Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 27 e 31 dhe më 30 korrik 2007.

(Ndërhyrje e deputetes Besa Gaxherri)

BESA GAXHERRI- Zoti Kryetar!

KRYETARI KOLË BERISHA – E patët fjalën njëherë.

Procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 27 e 31 dhe më 30 korrik 2007 u janë shpërndarë deputetëve.

Pyes deputetët, a kanë vërejtje në këto dy procesverbale?

Nuk kanë.

Konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 27 e 31 dhe më 30 korrik 2007.

Kalojmë në pikën e dytë e rendit të ditës.

- Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 26.1 të Rregullores së Punës të Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta. Në afatin e paraparë janë parashtruar 18 pyetje parlamentare. Pyetjet të cilat nuk arrijnë të procedohen sot, do të radhiten në seancën tjetër.

Vazhdojmë me pyetjet. Deputeti Xhevat Bislimi, ka pyetje për ministrin Çeku. Urdhëroni, zoti Bislimi!

XHEVAT BISLIMI – Zoti ministër, Kastrioti dhe fshatrat përreth termoelektranave janë vendbanimet më të rrezikuara dhe më të dëmtuara nga prodhimi i energjisë elektrike. Megjithatë, Komuna e Kastriotit dhe banorët e saj nuk kompensohen dhe nuk përfitojnë asgjë. Pyetje: Pse nuk i furnizoni këta banorë të paktën 24 orë me rrymë dhe pse nuk i lironi nga pagesa e rrymës? Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Zoti ministër, ju e keni fjalën!

MINISTRI ETHEM ÇEKU - Koleg i nderuar, sa i përket çështjes se sa kanë përfituar qytetarët e Komunës së Kastriotit dhe të Fushë Kosovës, po i marr për të dyja bashkërisht në raport me KEK-un, unë dua t'ju informoj se tani në punë, në marrëdhënie të punës, në raport me KEK-un janë 2.830 e diçka të punësuar në mes të Kastriotit dhe minierave dhe posaçërisht rreth KEK-ut. Sa i përket çështjes pse nuk i lirojmë nga pagesa e energjisë elektrike, ne mendojmë se tani me ligjin e ri, i cili është duke u hartuar dhe aprovuar nga ana e juaj, ju me të drejtë e ngritni këtë shqetësim, do të jenë komunitetet ato të cilat nga zhvillimi i kompleksit të minierave do të janë përfitues, njëri nga përfituesit e mirë të këtij raporti. Ne, po ashtu, jemi duke diskutuar edhe me këto dy komuna që t'i ndihmojmë në aspektin e furnizimit me energji disa nga vendet e ndjeshme, siç është ndriçimi publik dhe disa të tjera. Po ashtu, institucioneve shkollore u kemi siguruar që t'i furnizojmë me thëngjill. Pra, janë një varg përfitimesh të cilat janë duke u bërë për qytetarët e këtyre dy qytete apo dy rajoneve në raport me KEK-un. Mirëpo, ju e dini Xhevat, se ne nuk mund të lirojmë nga pagesa e energjisë elektrike qytetarët, jo vetëm aty, po në të gjithë Kosovës. E kemi trajtuar çështjen e rasteve sociale dhe në qoftë se janë raste sociale dhe raste të tjera, ata kanë të drejtën e lirit për një sasi të caktuar të energjisë elektrike. Prandaj, janë një varg politikash të cilat i kemi ndjekur në raport me ato zona që kanë ndikime, posaçërisht rreth çështjes mjedisore dhe problemeve të tjera.

Po ashtu, ju tashmë jeni të informuar edhe për disa spektra në raport me Kosovën C. Ato zona do të kenë edhe privilegje të caktuara për shkak të ndikimeve të tyre. Të gjitha këto janë duke u trajtuar me ligjin i cili është aprovuar nga ju dhe besojmë që do të nënshkruhet edhe nga PSSP-ja që të hyjë në fuqi. Kaq lidhur me këtë. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Zoti Bislimi keni bërë pyetjen e 12-të, jo të parën me radhë. A keni pyetje shtesë?

XHEVAT BISLIMI – Zoti ministër, megjithatë unë kam dëgjuar disa herë edhe kryetarin e Komunës së Kastriotit, i cili ka ngritur shqetësimin dhe ankesat e tij dhe ai thotë se nga Komuna e Kastriotit s'ka asnjë të punësuar, të paktën ata që janë të regjistruar në Komunën e Kastriotit. Përveç kësaj, degradimi i mjedisit, kontaminimi i ujit, i ajrit janë në një shkallë që vërtet s'e di çfarë përfitimesh mund të kenë ata edhe po të hynin në punë, në qoftë se rrezikojnë jetën e tyre, shëndetin e tyre. Në këtë aspekt mendoj që Ministria e juaj ka çka të bëjë për ta ndihmuar atë popullatë, por sidomos duhet pasur parasysh që janë fshatra, janë banorë që po e paguajnë shumë shtrenjtë me shëndetin e tyre, prandaj edhe në qoftë se lirohen nga pagesa e energjisë elektrike dhe u garantohet furnizimi 24 orë nuk është ndonjë kiamet i madh, sepse edhe ata janë pa rrymë njësoj si krejt Kosova. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Bislimi ka prapë pyetje për Kryeministrin Çeku. Urdhëroni, zoti Bislimi!

XHEVAT BISLIMI – Kjo pyetje është bërë para se të futet si pikë e veçantë çështja e zjarreve në Kosovë. Pyetja ka qenë: Ka apo nuk ka qeveri ky vend? Unë e mora përgjigjen gjatë kohës së zjarreve që nuk ka qeveri ky vend pasi që nuk kishte të drejtë as ta shuaj zjarrin, e lëre më të bëjë ndonjë veprim tjetër. Ju faleminderit! E kam marr përgjigjen.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Emrush Xhemajli ka pyetje për ministrin Jonuz Salihu. Urdhëroni, zoti Xhemajli! Dëshironi ta përsëritni pyetjen?

EMRUSH XHEMAJLI – Mirë, faleminderit!

I respektuari ministër,
Përveç ministër, ju jeni edhe anëtar në Këshillin e Lartë Gjyqësor të Kosovës. Brengë e shumë qytetarëve që kanë punë me drejtësinë është jo vetëm puna e ngadalshme e gjykatave, por edhe pasi lëndët e marrin formën përfundimtare, vendimet nuk ekzekutohen. Pyetja ime është kështu: Pse edhe pas përfundimit të lëndëve ato nuk përmbahen, përkatësisht nuk ekzekutohen. Konkretisht, pse është kështu gjendja dhe çka jeni duke ndërmarrë që të përmirësohet sistemi gjyqësor në këtë drejtim?

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni, zoti ministër, ju e keni fjalën!

MINISTRI JONUZ SALIHAI – I nderuari Kryetar i Kuvendit,
I nderuari Kryeministër,
Të nderuar deputetë,
Zoti Xhemajli,

Lidhur me pyetjen tuaj, e cila ka të bëjë me ekzekutimet gjyqësore në gjykata të rregulla të Kosovës, ju informoj me sa vijon:

Gjatë muajit mars 2007 në gjykatat komunale në Kosovë kishim në punë 72.313 lëndë të ekzekutimeve. Nga numri i lëndëve në punë 60.681 ose 83.9% ishin lëndë të trashëguara nga viti paraprak, si lëndë të pazgjidhura, kurse 11.632 ose 16.1% kanë qenë lëndë të pranuar në punë gjatë periudhës raportuese. Në periudhën raportuese gjykatat kanë zgjidhur 6.899 ose 9.5% të lëndëve në punë, kurse në fund të periudhës raportuese kanë mbetur të pazgjidhura 65.414 ose 90.5% të lëndëve në punë.

Struktura e ekzekutimeve të pazgjidhura është si në vijim: 6.999 ose 10.7% janë ekzekutime të lëndëve civile sipas dokumentit përmbarues, aktgjykimet e formës prerë, ujdite gjyqësore e tjerë, 10.141 ose 15.5% janë ekzekutime të paushallëve dhe të shpenzime procedurale në procedurën civile, 32.811 ose 50.2% janë ekzekutime sipas dokumenteve autentike, faturat borxhe për rrymë, telefon, komunalit të ndryshme, 1.716 ose 2.6% janë ekzekutime të dënimeve me burg, procedurë penale, 1.708 ose 2.6% janë ekzekutime të dënimeve me gjobë, procedurë penale, 173 ose 0,3% janë ekzekutime të dënime me alternative, dënime me kusht dhe gjysmë liria dhe 11.866 ose 18.1% janë ekzekutime të paushallëve dhe të shpenzimeve procedurale, të procedurës civile.

Shkaqet të cilat i kanë sjellë gjykatat komunale në këtë gjendje janë të llojllojshme. Numri i ekzekutuesve nuk ka qenë adekuat me fluksin e lëndëve të pranuar në punë. Për shembull, në fund të vitit 2003, numri i lëndëve të ekzekutimeve të pazgjidhura ka arritur shifrën 43.980 dhe atëherë është alarmuar se duhet të rritet numri i ekzekutuesve nga numri 40 në 70. Tani punojnë 63 ekzekutues, kjo do të thotë se numri i ekzekutuesve nuk është zmadhuar në raport me zmadhimin e lëndëve. Kreditorët asnjëherë nuk kanë bërë dorëzimin e propozimeve për ekzekutim në mënyrë sukseseve, por kanë pritur që të grumbullohen lëndët, kështu që gjykatat janë bllokuar nga grumbullimi i lëndëve. Për shkak të ndërrimit të shpeshtë të emrave të rrugëve dhe të lagjeve është pamundësuar verifikimi i adresave të debitorëve. Numri i vogël i gjyqtarëve ekzekutues dhe numri i vogël zyrtarëve ekzekutues. Sigurimi personave zyrtarë që e zbatojnë ekzekutimin ndodh të mos jetë adekuat për shkak të zënies me punë të policisë.

Çështja e mos gjetjes të xhirollogarive të debitorëve në bankat e ndryshme, ekzekutuesve u shkakton po ashtu probleme. Për punën e vështirë dhe me përgjegjësi, e cila është edhe e rrezikshme, ekzekutorët nuk marrin stimulime të posaçme. Automjetet në të shumtën e rasteve paraqesin probleme shumë të mëdha për ekzekutimin e lëndëve. Ndodh që me rastin e daljes së referentëve ekzekutues në ekzekutim të shfrytëzohen automobilat e kreditorëve, e kjo gjë është e papranueshme. Për shembull, Gjykata Komunale në Prishtinë me 26 gjyqtarë dhe 11 ekzekutues ka vetëm 3 automjete.

Gjendja e vështirë ekonomike e debitorëve është edhe një arsye e moszbatimit të ekzekutimit dhe shumë shkaqe të tjera, të cilat, për afërsisht janë të njëjta në të gjitha gjykatat komunale në Kosovë. Gjithashtu, problem më vete paraqet ekzekutimi i lëndëve civile në enklava, në gjykatat komunale të Leposaviqit, të Zubin Potokut dhe të Shtërpcës. Problem paraqet fakti se në territorin e këtyre gjykatave mjet pagese është dinari. Përveç asaj çka u tha më lartë, në rritjen e numrit të lëndëve ndikon efikasiteti i ulët i ekzekutuesve dhe gjyqtarëve ekzekutues. Për mënjanimin e shkaqeve të cekura më lartë, më parë Departamenti i Administratës Gjyqësore ka organizuar takime me të gjithë ekzekutuesit, gjyqtarët ekzekutues, KEK-un, Ujësjiellësin dhe Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës. Më vonë, me pranimin e ekzekutuesve të ri janë organizuar seminare dyditore për ekzekutorë të të gjitha gjykatave.

Me nxjerrjen e Rregullores Administrative 2005/52 është themeluar Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Preambula e kësaj Rregulloreje parashikon se Këshilli është themeluar me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes të një gjyqësori të paanshëm, të integruar, të pavarur, profesional dhe të përgjegjshëm, duke marrë parasysh riorganizimin në vazhdim të sistemit gjyqësor të Kosovës. Rregullorja 2005/52 parashikon që Këshilli Gjyqësor i Kosovës të jetë përgjegjës për përcaktimin e politikave administrative dhe siguron mbikëqyrjen dhe administrimin e të gjitha gjykatave. Këshilli Gjyqësor i Kosovës më 16. 4. 2007 ka miratuar planin strategjik për Gjyqësorin e Kosovës, i cili do të shërbej si udhëzues për zhvillimin e sistemit gjyqësor të Kosovës për periudhën 2007/2012.

Duke u bazuar në detaje të planit strategjik, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka formuar një grup punues i cili është duke punuar në planin operacional me të cilin plan...(ndërprerje).

KRYETARI KOLË BERISHA – Zoti ministër, përfundojeni! A ka pyetje shtesë? Jo. Ju faleminderit!

Në mungesë të zëvendësministrit Tomë Hajdaraj, pyetja e Mazllom Kumnovës mbetet pa përgjigje në këtë seancë.

Deputeti Canziba ka pyetje për ministrin Kuçi, edhe ky mungon.

Deputeti Canziba prapë ka pyetje për ministrin Qemajl Ahmeti. Doni ta përsëritni pyetjen, zoti Canziba? Urdhëroni!

XHELAL CANZIBA - Rruga 4 kilometërshe, e cila lidh Rahovecin dhe Therandën nuk është asfaltuar, edhe pse kjo rrugë ka qenë në plan të Ministrisë. Qytetarët presin me padurim asfaltimin e kësaj rruge, e cila mundëson një qarkullim të lirshëm dhe të shpejtë të banorëve të këtyre lokaliteteve. Pyetja: Pse është larguar nga prioriteti i Ministrisë asfaltimi i kësaj rruge dhe pse nuk merren hapat konkret për të realizuar këtë projekt shumë vital për qytetarët e Therandës dhe të Rahovecit?

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Ministër Ahmeti, e keni fjalën.

MINISTRI QEMAJL AHMETI – I nderuari Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Kryeministër,

Kolegë ministra,

I nderuari deputet Canziba,

Kjo pyetje pak është e vonuar ndoshta për përgjigje, sepse Ministria as nuk e ka hequr prej prioritetit, por kanë qenë procedurat e prokurimit. Në një moment është dashur të rikthehet procedura prej fillimit dhe tashmë është kah punohet në atë rrugë, me sa kam dijeni. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Keni pyetje shtesë!

XHELAL CANZIBA – Cilat janë kriteret për ndarje nga buxheti i Ministrisë për investime të rrugëve nëpër komuna, a ka kriter?

KRYETARI KOLË BERISHA – Zoti ministër, a keni përgjigje?

MINISTRI QEMAJL AHMETI – Po. Kjo pyetje është krejtësisht pyetje e re, nuk ka të bëjë pyetjen, për të cilën ndoshta duhet procedurë e re. Nëse nuk ju marrë kohë, unë mund të jap edhe këtë përgjigje. Po le të vlerësojë Kryetari i Kuvendit. Faleminderit!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Nait Hasani, ka pyetje për Kryeministrin Çeku. Doni ta përsëritni pyetjen, zoti Hasani? Deputeti Hasani e ka fjalën!

NAIT HASANI – Faleminderit, Kryetar!

I nderuari Kryeministër,

Pyetja ime është: Sipas rregullimit të Ligjit për furnizime me derivate të mazutit, biznesi në Kosovë është furnizuar nga Shqipëria deri para dy muajve. Tani është ndryshuar kjo por, megjithatë, ndërsa me vendim administrativ nga Qeveria është ndërprerë furnizimi nga Shqipëria dhe është lejuar furnizimi nga Serbia, me të cilin është dëmtuar biznesi në Kosovë. Cila është arsyeja e ndërprerjes së furnizimit me mazut të biznesit në Kosovë me 290 euro për tonë, ndërsa është lejuar furnizimi nga Serbia me të njëjtën lëndë mazuti me 460 euro. Kush e ka dhënë këtë leje që të bëhet ky ndryshim?

KRYETARI KOLË BERISHA – Zoti Kryeministër, urdhëroni!

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Faleminderit Nait për pyetje.

Tregtia me naftë dhe derivatet e naftës rregullohet sipas Ligjit nr. 2004/5 dhe akteve nënligjore si dhe Udhëzimit administrativ 2006/16 për cilësinë e derivateve të naftës. Nuk ekziston asnjë akt ligjor apo nënligjor si dhe asnjë veprim i strukturave rregullative të kësaj fushe që pengon tregtinë me derivatet e lëngëta të naftës nga Shqipëria, Maqedonia apo çfarëdo vendi tjetër. të gjitha veprimet që i ka marrë Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë janë në funksion të ngritjes së cilësisë së këtyre produkteve dhe kanë për qëllim mbrojtjen e ambientit, mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve. Asnjë veprim nuk është kryer me qëllim të favorizimit të importit nga Serbia. Pasi që ka filluar zbatimi i Udhëzimit administrativ 2006/16 për cilësinë e karburanteve të naftës, janë vërejtur mungesat e sasisë së mazutit me parametra të kërkuar në bazë të Udhëzimit administrativ. Kështu që komuniteti i biznesit ka kërkuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë të paraqesë në Qeveri rishikimin e nenit 9 të këtij Udhëzimi administrativ. Sipas parametrave të kërkuar me këtë Udhëzim Administrativ, në rajon ka qenë vetëm një rafineri e naftës apo një prodhues i produkteve të naftës i cili i ka përmbushur këto parametra të kërkuara dhe ky prodhues e ka pasur vetëm një përfaqësues ekskluziv për Kosovë, kështu që i ka vënë në pozitë jo të barabartë importuesit e tjerë të produkteve të naftës. Ne, me kërkesën e këtyre importuesve të naftës, të Odës Ekonomike të Kosovës dhe të Komunitetit të biznesit në përgjithësi e kemi rishikuar këtë nen dhe që nga koha kur e kemi rishikuar para një muaji, kemi vendosur që për mazutin dhe vajin solar të vazhdojmë kriteret e mëhershme pa masa kufizuese deri në vitin 2009. Por, gjithashtu, kemi kërkuar nga kompanitë prodhuese që të investojnë në filtrat e nevojshëm dhe që nga viti 2009 ne do t'u kthehemi parametrave të kërkuar që janë në përputhje me kriteret evropiane, do me thënë bëhet fjalë për 2% sulfur që konkretisht duhet t'i ketë. Kështu, kjo kërkesë e Komunitetit të Biznesit është aprovuar nga Qeveria dhe vazhdojmë me kriteret e mëparshme në importin e mazutit dhe tani importuesit tanë kanë qasje në treg, jo vetëm në Serbi, por edhe në tregun në rajon apo te prodhuesit e mëhershëm.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Keni pyetje shtesë, zoti Hasani? Urdhëroni!

NAIT HASANI – Unë desha ta falënderoj Kryeministrin për këtë informacion. Tani përsëri jemi të helmuar nga sulfuri për 2%, apo nga humbja e dëmi i biznesit për 460 euro për ton.

KRYETARI KOLË BERISHA – Vazhdojmë me pyetjen tjetër. Në mungesë të ministrit Grbiq, pyetjen e deputetit Nait Hasni mbetet pa përgjigje.

Po ashtu, në mungesë të ministrit Veliu, pyetja e deputetes Sala Ahmetaj mbetet pa përgjigje.

Deputetja Sala Ahmetaj, ka pyetje për ministrin Qemajl Ahmeti. Doni ta përsërisni pyetjen?

Nuk ka përgjigje Naiti. Vazhdon Sala!

SALA AHMETAJ – Unë kam një pyetje dhe për Kryeministrin, a është në radhë tani pas kësaj apo, besoj se do të jetë tani. Pyetje për ministrin e Transportit dhe të Postelekomunikacionit, zotin Qemajl Ahmeti. Dukuria e braktisjes së fshatrave nga banorët është e pranishme. Në shumë raste, arsyeja kryesore është infrastruktura e dobët e rrugëve, e cila e pamundëson qarkullimin normal të njerëzve. Në fshatin Radishevë, rruga e gjatë 6 kilometra para 4 vitesh është shtruar me zhavorr nga Ministria, por sot është e dëmtuar tërësisht dhe e ka vështirësuar qarkullimin e njerëzve dhe mundësinë për t'u marrë me veprimtari të ndryshme, si përpunimi i drurit, turizmi i fshatit e të tjera. Pyetja: Pse Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit nuk e ka vazhduar projektin dhe nuk e ka finalizuar për të përfunduar në tërësi shtruarjen me asfalt të kësaj rruge, e cila, përveç tjerash, është edhe me interes strategjik dhe kombëtar?

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni, zoti ministër Ahmeti!

MINISTRI QEMAJL AHMETI – Faleminderit! Kjo rrugë është rrugë lokale dhe nuk mund të vihet në prioritet nga Ministria për shkak se nuk është përgjegjësi e saj, por mund të ndihmohet nëse kuvendi komunal e vë në prioritet dhe kërkon ndihmesë nga Qeveria, përkatësisht nga Ministria, siç bëhet edhe për shumë projekte të tjera anembanë Kosovës. Është e vërtetë që në fazën e parë Ministria e ka shtruar atë rrugë në bashkëpunim me Kuvendin Komunal të Skenderajt. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Keni pyetje shtesë? Urdhëroni!

SALA AHMETAJ – Unë do të doja të dija cilat janë kriteret për ndarjen e buxhetit nga Ministria për komunat, sepse ka komuna në të cilat ju i keni shtruar edhe shumë rrugë të fshatrave.

KRYETARI KOLË BERISHA – Zoti ministër, keni përgjigje? Urdhëroni!

MINISTRI QEMAJL AHMETI – Pyetja është e njëjtë, do me thënë është pyetje e re, cilat janë kriteret? Unë dua ta informoj deputeten se në Komunën e Skenderajt Ministria ka participuar ose participon me 100 mijë euro për një rrugë tjetër, jo për këtë, sepse komuna e Skenderajt ka vë në prioritet një rrugë tjetër. Prioritetet e rrugëve lokale dhe urbane Ministria nuk mund t'i vë në rend dite, as t'i ndërrojë prioritetet të cilat i ka përcaktuar komuna. Është e logjikshme që infrastruktura është, por mjetet na diktojnë edhe prioritetet. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Mirë, faleminderit! Deputetja Sala Ahmetaj ka pyetje për Kryeministrin Agim Çeku. Urdhëroni! Sala Ahmetaj e ka fjalën.

SALA AHMETAJ – I nderuari Kryeministër,

Para disa javësh në fshatin Radishevë njerëz të armatosur dhe me uniforma u ndeshën me banorët e fshatit duke i kërcënuar ata. Falë syçeltësisë dhe maturisë së banorëve, nuk ndodhi ndonjë strategji. Kjo nuk është hera e parë që njerëz të tillë shqetësojnë banorët e këtij fshati. Pyetja është: A e ka hetuar Qeveria rastin e Radishevës dhe a ka Qeveria të dhëna se kush mund të qëndrojë prapa këtyre grupeve të armatosura dhe çka ka ndërmarrë Qeveria që t'u ofrojë siguri banorëve të këtij fshati në mënyrë që ai të mos braktiset tërësisht? Pas pyetjes që kam bërë unë, në Radishevë ka pasur edhe zhvillime të tjera për të cilat shpresoj se Kryeministri do të na informojë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni, zoti Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Faleminderit, zonja Ahmeti!

Po, siç thatë edhe ju, konkretisht më 14 .07 të këtij viti, rreth orës 16,00, në fshatin Radishevë, Komuna e Skenderajt, disa fshatarë kanë vërejtur disa persona të armatosur në fshatin e tyre. Me këtë rast kanë lajmëruar SHPK-në, e cila ka qenë shpejtë në vendin e ngjarjes dhe ka pasur të shtëna në mes të këtyre personave dhe SHPK-së. Në vendin e ngjarjes ka dalë shumë shpejtë edhe KFOR-i. Unë kam takime të shpeshta të rregullta me komandantin e KFOR-it dhe komisionarin e Policisë dhe shefin e UNMIK-ut, ku e vlerësojmë situatën e sigurisë në vend dhe në një takim të veçantë e kemi shqyrtuar këtë çështje dhe kam kërkuar raport edhe nga KFOR-i, edhe nga Policia. Edhe KFOR-i, edhe Policia konfirmojnë që aty ka pasur persona të armatosur. Nuk kanë dëshmi që kanë qenë të uniformuar, por kanë qenë të armatosur, kanë shtënë me armë në drejtim të policisë dhe në vendin ku ata kanë qenë janë gjetur gjurmë që dëshmojnë se ata kanë qenë duke prerë dru në mënyrë ilegale. Kështu, ky është versioni zyrtar i komandantit të KFOR-it dhe i komisionarit të Policisë. Unë edhe vetë kam qenë në fshatin Radishevë, kam biseduar me fshatarët të cilët vërtet janë të shqetësuar për sigurinë e tyre që vërehen nëpër malet e fshatit Radishevë persona të dyshimtë, të panjohur dhe kanë kërkuar që të shtohen masat e sigurisë. Kryesisht kërkojnë nga KFOR-i që të jetë më prezent aty. Unë këtë kërkesë ia kam përcjellë komandantit të KFOR-it, i cili më ka premtuar që do ta ketë një vëmendje të theksuar në sigurinë e fshatit Radishevë. Gjithashtu i kam sugjeruar që të shkojnë në kuvendin komunal, kanë qenë edhe në Kuvendin Komunal të Skenderajt. Policia, gjithashtu, i ka shpeshtua patrullat në këtë vend. Situata tani paraqitet e qetë dhe stabile që nga ato ditë, por sidoqoftë, mbetet një kujdes i veçantë i strukturave të sigurisë në këtë fshat, por edhe në zonat e tjera kufitare.

Lidhur me pyetjen e parë, vetëm një koment. Në mbledhjen e Qeverisë para dy javësh, ne kemi shqyrtuar situatën në zonat kufitare në përgjithësi në Kosovë, dhe i kemi detyruar të gjithë ministrat që gjatë hartimit, por edhe shpenzimit të buxhetit për vitin 2008, vëmendje të veçantë t'ju kushtojnë vendbanimeve me zona kufitare, ku pa dyshim edhe Radisheva është një vendbanim, siç thatë edhe ujë, vend shumë i rëndësishëm për sigurinë e Kosovës. Kështu, besoj që në vitin 2008 do të gjejmë mundësi më të mëdha që t'i mbështesim banorët e këtij fshati që të jenë të sigurt, sepse siguria është parakusht i parë që ata të qëndrojnë aty, e qëndrimi i tyre është interes jetik i yni. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Dy pyetjet e deputetit Hydajet Hyseni, në mungesë të ministrit Grbiq dhe të Lutfi Hazirit mbesin pa përgjigje në këtë seancë.

Shkojmë më tutje. Deputeti Ramadan Kelmendi ka pyetje për ministrin Sadik Idriz. Urdhëroni! Doni ta përsërisni pyetjen?

RAMADAN KELMENDI – I nderuari ministër. Në kohë të fundit, në tërë Kosovën janë mbyllur barnatoret shtetërore. Si pasojë, barërat shpërndahen nëpër shtëpi të shëndetit nga persona jo të autorizuar dhe jo profesional, mungon kujdestaria e natës për barëra. Të gjithë këta punëtorë ishin punëtorë të qendrës shëndetësore, e tani janë të papunë. Cili është qëndrimi i Ministrisë lidhur me këtë problem shumë të hapur. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI SADIK IDRIZ – Poštovani poslaniče Keljmendi, Društvene ili državne apoteke o kojima vi govorite nisu u nadležnosti Ministarstva zdravlja još od 2002. godine. Nakon privatizacije Farmeda, ove apoteke su date na menadžiranje Farmaceutskoj korporaciji Kosova KFK, koja dobila tender za deponiranje, distribuciju i disperziciju lekova sa esencijalne liste.

U septembru 2006. godine istekao je ugovor za disperziju. Vlada je odlukom od 23. avgusta prošle godine preporučila da se ugovor produži samo do 31. decembra 2006. godine, a da u tom periodu Ministarstvo zdravlja ponudi alternativni plan za disperziju. Napominjem da je po ugovoru za disperziju KFK dobijala oko 832.000 € godišnje. Disperziju vršila samo za primarno zdravlje. Kada je u zadnjim godinama smanjen budžet za lekove, ispalo je da se vršila disperzija, što se reči raspodela lekova čija je suma oko 1.5 miliona evra, a da su troškovi bili oko 832.000 €. Tako, radna grupa je preporučila da disperziju vrši centri Porodične medicine. Čekamo ..., koji su izrazili spremnost da to radi i da imaju infrastrukturu za obavljanje ovih poslova. Dakle, danas svi lekovi za esencijalne liste se djele preko Centara porodične medicine. Što se radnika ovih apoteka tiče, oni su imali ugovor nakon privatizacije sa ovom korporacijom. Od momenta raskida ugovora između Ministarstva zdravlja i KFK, kada nije dobila tender, ova je prekinula ugovor sa njima. Ministarstvo zdravlja oseće ovaj problem zajedno sa radnicima, te je preporučilo opštinama da ovi radnici imaju prednost u zapošljavanju i da im se nekako reši status. Međutim, trenutno postoje limiti u zapošljavanju radnika u oblasti zdravlja na svim nivoima. Znači, ovim radnicima bi prestao ugovor i u slučaju da KFK nije dobila tender, da smo produžili tender. Znači, oni su bili radnici, nakon privatizacije nisu imali ugovor sa Ministarstvom, nego su imali ugovor sa KFK-om. KFK nije više dobila taj tender i oni su ostali. To je problem koji imaju i ostale organizacije kada se izvrši privatizacija. Hvala!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Keni pyetje shitesë? Urdhëroni!

RAMADAN KELMENDI – Ministër, vlerësoj se jeni në dijeni se barnatorja, të them kushtimisht, shtetërore në Mitrovicë, e cila i plotëson të gjitha kriteret, do të bëhet kafene. Ku është interesi ynë këtu? Kjo është tmerr. Kafene po bëhet, po privatizohet. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Zoti ministër, urdhëroni!

MINISTRI SADIK IDRIZ – Kad je u pitanju privatizacija, mi nismo tu odgovorni. To je pitanje AKM i mi ne možemo zaustaviti nešto što se privatizuje. Nemamo znači te ingerencije. Mi nismo uspeli kada je privatizovan Farmed, koji je bio značajna institucija. Te apoteke će doći na red i to je pitanje privatizacije koje mi nismo moćni da zaustavimo. Hvala!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Jonuz Kastrati ka pyetje për ministrin Ardian Gjini. Doni ta përsërisni pyetjen? Urdhëroni zoti Kastrati! Jonuz Kastrati e ka fjalën.

JONUZ KASTRATI – Faleminderit Kryetar,
I nderuari ministër,

A keni ndërmarrë diçka në rastin kur në Ujëvarat e Mirushës nuk ka rrjedhur as edhe një pikë ujë. Për më tepër, nga baseni i Banjës në shtratin e Lumit Mirushë është derdhur e njëjta sasi e ujit sikur edhe viteve të tjera, që do të thotë se ka pasur keqpërdorim shumë të madh të ujit. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni, zoti ministër Gjini!

MINISTRI ARDIAN GJINI – Faleminderit, zoti Kryetar,
Zoti Kryeministër,
Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës,

Duhet konstatuar se që prej datës 20 korrik të këtij viti ka pasur vizita të shpeshta të ekspertëve të Ministrisë së Mjedisit në Mirushë dhe në rrjedhën e Lumit Mirusha dhe në Ujëvarat e Mirushës. Janë diku 32 kilometra rrjedhë të Mirushës, me përafërsisht 10 hektarë sipërfaqe të rrjedhës. Gjatë të gjitha vizitave ekspertët e Ministrisë së Mjedisit nuk kanë mundur të konstatojnë se ndërprerja e rrjedhës në liqene është për shkak të keqpërdorimit të ujit. Janë bërë disa vizita. Arsyeja pse në fund të rrjedhës ende ka ujë, është për shkak të burimeve të fuqishme të cilat e mbushin rrjedhën, jo prej burimit kryesor, mirëpo më poshtë, e sidomos prej dy burimeve të cilat gjenden nën liqenin e 16-të, të cilat prapë se prapë e mbajnë rrjedhën në pjesën e Ulët të Lumit Mirushë. Në pjesën e Epërme nuk ka rrjedhë të ujit për shkak të thatësisë, do të thotë nuk është për shkak të keqpërdorimit, por për shkak të thatësisë. Mendoj se të gjithë deputetët e kanë të qartë se kur është thatësi, jo vetëm Ministria, po askush tjetër nuk ka mundësi të bëjë diçka për të kthyer rrjedhën. Nuk janë shpikur metodat të cilat kishin për ta kthyer rrjedhën e lumit nëse është për shkak të thatësisë. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Ka pyetje shtesë? Urdhëroni!

JONUZ KASTRATI – Sa për informim, i nderuari ministër, unë jetoj dhe jam i përditshëm në Malishevë. Jo për të polemizuar, po e thashë se e njëjta sasi e ujit derdhet në Banjë, ka ujë, shkon në Malishevë, të tjerat s'po i përmendi. Vetëm në rrjedhën ku gravitojnë fshatrat Turjakë, Damanek, Bubël e Qupevë ka ujë, mandej shtrati mbetet i thatë. Unë thashë, këto vinë sidomos në dy fshatrat Banjë dhe Malishevë, po edhe në dy fshatrat në vijim. Këtu për qytetarët në Malishevë është shumë e qartë kjo, megjithatë është çështja e ekspertëve të juaj dhe e të tjerëve se si e kanë konstatuar gjendjen. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI ARDIAN GJINI – Me qenë se ju, zoti deputetë, e nxorët në këtë formë, atëherë duhet thënë se polemikën e shndërruat në atë se çka është keqpërdorim, e çka është përdorim. Njerëzit që jetojnë në ato fshatra gjithmonë kanë marrë ujë prej rrjedhës së Mirushës dhe keqpërdorim mund ta quajmë nëse ka diçka të re që ka ardhur aty, një pompim të madh i cili ka për ta ulur rrjedhën e lumit. Edhe një herë po them, ne kemi për

të dalë prapë në terren, ekspertët e Ministrisë së Mjedisit kanë për të dalë prapë në terren, mirëpo deri më tani nuk është konstatuar se rrjedha e lumit është ndalë për shkak të keqpërdorimit. Ajo është ndalë për shkak të thatësisë së madhe. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në mungesë të ministrit Velu, deputeti Jonuz Kastrati nuk merr përgjigje në këtë seancë.

Deputetja Safete Haderxhonaj do të marrë përgjigjen në seancën e ardhshme të radhës për pyetjen që e ka shtruar.

Deputeti Xhevat Bislimi tash i kthehet pyetjes së përparshme që ka harruar ta bëjë për Kryeministrin Çeku. Kjo është pyetja e fundit.

XHEVAT BISLIMI – Faleminderit, zoti Kryetar. Unë nuk kam harruar, e kam bërë këtë pyetje tashmë 6 muaj dhe e kam përsëritur dy - tri herë edhe në administratë, megjithatë nuk prish punë.

Zoti Kryeministër, kthimi dhe angazhimi i të rinjve tanë të shkolluar në universitetet e Perëndimit. Jemi dëshmitarë që koalicioni qeveritar LDK, AAK dhe institucionet e udhëhequra nga ky koalicion kanë shpenzuar dhe vazhdojnë të shpenzojnë miliona euro të taksapaguesve tanë për trajnimin dhe arsimimin e nëpunësve dhe funksionarëve të të gjitha niveleve. Sot, zoti Kryeministër, në Perëndim jetojnë mbi 500.000 shqiptarë të shpërngulur nga Kosova vetëm nga viti '81 e këndej. Midis këtyre të dëbuarve ka mijëra djem e vajza të shkolluara në universitetet e vendeve ku janë të vendosur. Pyetja: A ka bërë dhe pse nuk ka bërë Qeveria e juaj ndonjë projekt apo plan për rikthimin e tyre në Kosovë dhe për angazhimin e tyre si profesionistë në lëmit përkatëse si: në administratë, ekonomi, arsim, gjyqësi dhe shumë lëmi të tjera në Kosovë? Ju Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni, zoti Kryeministër!

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Faleminderit Xhevat edhe për këtë pyetje! Një ndër prioritetet e Qeverisë së Kosovës është gjithsesi edhe ngritja e kapaciteteve brenda institucioneve tona dhe për këtë mënyra më e mirë është angazhimi i kuadrove përkatëse, do me thënë, të specializuara në fushën konkrete. Ne kemi bërë përpjekje në këtë drejtim. Angazhimi i ekspertëve apo qytetarëve tanë të shkolluar jashtë vendit ka qenë problem dhe pengesa kryesore ka qenë paga e ulët të shërbyesve civil në institucionet tona. Andaj kemi kërkuar ndihmë nga donatorët e ndryshëm dhe kemi marrë këtë ndihmë përmes programit të ndërtimit të kapaciteteve, apo Fondit të ndërtimit të kapaciteteve. Nga disa donatorë ne kemi angazhuar shumë të rinj që janë shkolluar në vendet perëndimore. Vetëm në Zyrën e Kryeministrit sot punojnë 29 ekspertë të cilët janë shkolluar jashtë, kurse në ministrinë e tjera 50 të tjerë janë shkolluar jashtë, por këta të gjithë paguhën nga donatorët, do me thënë nga UNDIP-ia, OSBE-ja, nga DIFID-i, nga USAID-i e tjerë, e tjerë. Kështu, ju kujtohet, kemi pasur një përpjekje që për t'i ruajtur këta ekspertë, kemi propozuar në Qeveri, bile kemi pas marrë një vendim, të cilin e kemi anuluar për shkak të reagimit që t'i mbajmë këta ekspertë dhe për këta ekspertë pikërisht të bëjmë një pagesë shtesë, por kjo nuk u arrit dhe ne kemi vështirësi për mbajtjen e këtyre ekspertëve dhe jemi duke bërë përpjekje përmes donatorëve që ata ende të qëndrojnë. Ata janë shumë të dobishëm dhe janë kritik për mbarëvajtjen e punëve në institucionet tona.

Gjithashtu, kemi investuar në drejtimin tjetër që t'i dërgojmë në shkollim jashtë vendit punonjësit tanë, shërbyesit civilë, djem e vajza të reja që i kemi në punë dhe kemi arritur shumë suksese. Vitin e kaluar i kemi ndarë 39 bursa vetëm për studentë të ri dhe sivjet i kemi ndarë 600.000 euro për 30 zyrtarë që do t'i dërgojmë në studime master në fushën e legjislacionit evropian për të qenë të aftë të hartojnë ligjet apo t'i adaptojnë ligjet me legjislacionin evropian. Gjithashtu, nga UE, përmes AER-it, sivjet kemi arritur të

sigurojmë 1 milion euro për shkollimin e 40 zyrtarëve tanë në universitetet evropiane. Por, njëkohësisht edhe AER-i vazhdon skemën e quajtur JAN CEL në edukimin apo dërgimin e shërbyesve tanë civil në universitetet për studime master. Deri më tash 35 e kanë përfunduar. Të premten kam qenë në një ceremoni kur i kemi përcjellë edhe 15 zyrtarë të tjerë në shkollim jashtë vendit. Kështu që pritet që brenda 2 – 3 viteve brenda institucioneve tona t'i kemi 200 ekspertë të shkolluar jashtë vendit që do të jenë në gjendje të përballen me sfidat e integritetit evropian apo me rritjen e kapaciteteve vepruese të institucioneve tona. Dua ta them këtë që personat të cilët përfitojnë nga këto skema që i dërgojmë jashtë, kanë kontratë tri vjeçare, janë të obliguar që së paku 3 vjet të shërbejnë brenda institucioneve të Kosovës.

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit, zoti Kryeministër! Ka pyetje shtesë. Urdhëroni, zoti Bislimi!

XHEVAT BISLIMI – Zoti Kryeministër faleminderit!

Unë e kam shumë të qartë që ka njerëz që punojnë në organizatat të huaja, e kam shumë të qartë që ju keni shpenzuar miliona për të dërguar njerëz jashtë. Pyetja ishte: Pse ose a keni bërë ndonjë plan për kthimin e fëmijëve, të njerëzve që u detyruan në kushte shumë të rënda terrori dhe dhune të shpërngulen nga Kosova, për kthimin e tyre dhe angazhimin e tyre në qeverisjen e vendit, e jo nëpër organizata të huaja. Sa janë kthyer prej tyre dhe a keni ndonjë plan për kthimin e këtyre njerëzve, siç keni plane për kthimin e ikës të tjerëve. Kjo ishte pyetje. Unë e di që jeni duke shpenzuar para për të dërguar njerëz, djalin e atij, vajzën e këtij. Ne kemi mijëra djem e vajza jashtë, janë të shkolluar dhe duhet të kthehen, të integrohen dhe të shfrytëzohen për të mirën e vendit tonë. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Zoti Kryeministër.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Kthimi është vullnetar i çdo kujt. Të gjithë janë të mirëseardhur këtu. Thashë se problemi është te paga e ulët në shërbimin civil në Kosovë. Por, siç e dini, pagat janë pak më të larta në ndërmarrjet tona publike dhe me ndërmarrjet publike kemi realizuar një program i cili quhet EKSPAT, dhe pa procedurë apo me procedurë të shkurtër të konkurrencës pranohen ekspertë që janë shkolluar jashtë. Mund të them që në PTK me procedura të shkurtra janë pranuar 24 qytetarë tanë të shkolluar jashtë. E di që këtë pyetje e keni parashtruar kaherë dhe ndoshta tash ky numër tash është më i madh. Kështu, ne vërtet mund t'i ftojme këta njerëz, por kemi shumë pak çka t'u ofrojmë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit!

Propozoj 15 minuta pauzë për kafe. Në orën 11,30 kthehemi në sallë.

Vazhdimi i punës së seancës pas pauzës, në orën 11:30

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju lutem, i zini vendet, fillojmë punën. Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët, nr. 2003/11

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 28 qershor 2007 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Ftoj ministrin Qemajl Ahmeti që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin. Urdhëroni, zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI QEMAJL AHMETI – Faleminderit, i nderuari Kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë dhe ministra,

Nisma për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët nr. 2003/11 është ndërmarrë konform zgjidhjeve të dhënave në kreun V të Rregullores së UNMIK-ut 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme, të Rregullores së UNMIK-ut 2001/19 mbi degën ekzekutiv të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes së Kosovës me cilën, përveç të tjerash, definohen edhe përgjegjësitë e ministrive.

Në këtë drejtim, duke vepruar në përputhje me mandatin e dhënë, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit ka bërë përgatitjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët nr. 2003/11 i cili, si i tillë, në formën e propozuar është përgatitur nga një grup ekspertësh me shtrirje të gjerë ndërministrorë.

Përgatitja e këtij Projektligji është ngritur në rangun e prioritetëve të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit, të paktën për këto arsye:

Rrethanat e krijuara në sektorin e infrastrukturës rrugore që rezultojnë me nevojën e zgjerimit të rrjetit të rrugëve të llojit të tyre përfshin sidomos ato që kanë të bëjnë me autostradën, cilësinë e ndërtimit, ruajtjen e rrugëve nga dëmtimet e tjerë, gjatë viteve të fundit ka nxitur përkushtime dhe përgjegjësinë institucionale të Ministrisë për të krijuar e zbatuar një politikë të avancuar në këtë lëmë, e cila në rrethana të reja më mirë do t'u përgjigjej nevojave të qytetarëve dhe zhvillimit ekonomik. Në këtë drejtim, si Ministri konsiderojmë se një ndër veprimet e nevojshme në lidhje me këtë çështje do të ishin pa dyshim ato që kanë të bëjnë me plotësimin dhe ndryshimin e legjislacionit përkatës. Si rrjedhojë, përmes ndryshimeve dhe plotësimeve të propozuara në këtë Projektligj synohet të realizohet një konsolidim i fuqishëm i gjitha institucioneve të qeverisjes në kuadër të lëmit të infrastrukturës rrugore.

Në anën tjetër, arsyeja e ndërmarrjes së kësaj nisme ligjore qëndron në nevojën e vendosjes së mekanizmave gjegjëse që do të siguronin hapjen e shtigjeve për realizim më të efektshëm të çështjeve që ndërlidhen me mbarrëvajtje të punimeve, dhe jo vetëm të kësaj, në këtë sektor që shikohet si arterie bazë për zhvillimin ekonomik të vendit.

Më tutje, ndryshimet e propozuara janë në funksion të vendosjes së një politike publike që nxit zhvillimin e infrastrukturës rrugore në Kosovës dhe integrimin e saj në rrjetet rajonale dhe evropiane. Po ashtu, konsideroj se me amendamentet e propozuara infrastruktura ligjore për sektorin rrugor do të jetë më e plotësuar dhe e gatshme të përmbushë kriteret e parapara me aqua communitare të Bashkimit Evropian.

Ndryshimet e propozuara i referohen Kreut I, pra dispozitat e pjesës së përgjithshme, me ç'rast janë amandamentuar 7 nene, neni 2, 4, 6, 7, 8, 9 dhe neni 10. Në këtë drejtim, me këto ndryshime dhe plotësime, përveç tjerash, jepet nocioni i autostradës dhe përcakton rrugët e vendosjes së mekanizmave që do të garantonin një qeverisje të drejtë, mirëmbajtje efektive dhe kushte adekuate për ndërtim dhe rikonstruktiv të saj.

Rrjedhimisht, sa i përket mirëmbajtjes hapen shtigjet që përveç mirëmbajtjes së rregullt të rrugëve publike, të ketë edhe mirëmbajtje investive, me ç'rast përmes definimit të tyre dhe vendosjes së parametrave të tjerë synohet të avancohet mirëmbajtja si në aspektin kualitativ, ashtu edhe të efikasitetit.

Kreu IV, që rregullon çështjen e ndërtimit dhe rikonstruktimit, ku janë amandamentuar 4 nene, neni 15, 16, 18 dhe 19, në kuadër të këtyre ndryshimeve dhe plotësimeve janë parashikuar të vendosen kriteret e avancuara të mbështetura me standarde të pranuara ndërkombëtarisht të ndërtimit dhe të rikonstruktimit të rrugëve publike dhe të objekteve rrugore. Në këtë drejtim, ndër të tjera, është paraparë që stacionet e autobusëve duhet ndërtuar jashtë sipërfaqes për qarkullim të automjeteve, me çka synohet krijimi dhe ruajtja e stabilitetit të qëndrueshëm të qarkullimit të automjeteve në trafikun publik.

Kreu V, që normon çështjen e shfrytëzimit të rrugëve, ku janë propozuar për ndryshim, janë amandamentuar 8 nene, neni 21, 23, 25, 26, 27, 28, 29 dhe 30. Ndryshimet dhe plotësimet e propozuara në kuadër të këtij kreu, përveç të tjerash, synojnë avancimin e mbrojtjes së rrugëve publike, të objekteve rrugore, të sinjalizimeve nga ndërtimet e mundshme dhe kjo parashikohet të bëhet përmes vendosjes së sistemit adekuat të kontrollit, me ç'rast është paraparë të ndalohet çdo ndërtim i objekteve të tjera pa leje në pjesët e rrugës dhe të objekteve mbrojtëse.

Dhe, në fund, është sajuar Kreu VII me të cilin rregullohet çështja e dënimeve dhe të kundërvajtjeve, ku janë amandamentuar 3 nene, neni 34, 35 dhe 36. Me këto ndryshime e plotësime përmes përcaktimit të nivelit të gjobave synohet të sigurohet ruajtja adekuate e rrugëve publike, si dhe siguria më e madhe në ndërtimin e tyre dhe të objekteve rrugore. Siç duket, këto plotësime dhe ndryshime prekin disa çështje të shumta, po aq edhe **kyçe** sa i përket materies që i rregullon ky ligj në fjalë, por të cilat për momentin janë vlerësuar si të domosdoshme.

Bazuar në këto të dhëna, por edhe në çështje të tjera që janë pjesë e rregullimit të kësaj materije, besoj se ndryshimet dhe plotësimet e propozuara në Ligjin 2003/11 do të hasin në përkrahjen tuaj dhe kështu do të hapen shtigjet për procedim të mëtejshëm të tij. Në çdo rast mirëpres kontributin e Komisioneve përkatëse të Kuvendit në begatimin e mëtejshëm të këtyre ndryshimeve plotësuese. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, zoti ministër!
Fjalën e ka deputeti Ibush Jonuzi në emër të LDK-së.

IBUSH JONUZI – Faleminderit, i nderuari Kryetar i Kuvendit të Kosovës,
Ministra të pranishëm,
Të respektuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me kujdes dhe me vëmendje të posaçme Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë nr. 2003/11 të sponzoruar nga Qeveria e Kosovës, respektivisht nga Ministria për Transport dhe Telekomunikacion. Ministria për Transport dhe Telekomunikacion është duke bërë punë të mirë në plotësimin e infrastrukturës ligjore. Ky është ligji i dytë që vjen në Parlament nga kjo Ministri me të cilin iniciohen ndryshime dhe plotësime të ligjeve të hartuara më herët. Sipas kësaj, Ministria po krijon bazë e hapësirë më të mirë për transportin rrugor, infrastrukturën rrugore. Ndryshimet dhe plotësimet e Projektligjit për

rrugë, që sot po i shqyrtojmë në parim, edhe komisioni parlamentar funksional i ka vlerësuar pozitivisht, sepse ndryshimet e bëra në masë të madhe janë mjaft të qëlluara, por nuk do të thotë se nuk ka edhe më tutje vend për ndryshime të tjera si dhe për korrigjime dhe plotësime të disa neneve. Tani, me qenë se është shqyrtimi në parim, nuk do të ndalem në to, por në fazën e më tutjeshme të punës së komisionit parlamentar funksional ne do të japim kontributin tonë.

Prandaj, për fund, më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës ta mbështes në parim miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të PDK-së deputetja Hatixhe Hoxha.

HATIXHE HOXHA – Zoti Kryetar,

Në interes të një zbatimi më të mirë të Ligjit na janë sjellë ndryshimet të cilat mendohet se do të përplotësojnë më mirë Ligjin, në fakt Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë nr. 2003/11. Vërejtjet që janë sjellë, shumica kanë të bëjnë me përplotësimin, sidomos me pjesën që u dedikohet përkufizimeve, definicioneve e që mendojmë se janë shpjegime më të mira se sa që ato kanë qenë në ligj. Mirëpo, po e ritheksoj edhe një herë se gjatë hartimit të projektligjeve ministritë duhen të kenë kujdes që të gjitha ligjet t'i harmonizojnë në mes vete si dhe shpjegimet, gjegjësisht definicionet, përkufizimet të jenë të njëjta në të gjitha ligjet që prekin një sferë të caktuar. E re në këtë Projektligj është edhe çështja e autostradës, sepse me ligjin aktual nuk trajtojnë autostrada. Dëshiroj të theksoj këtu faktin se kisha shumë rezerva lidhur me vlerësimin e implikimeve buxhetore. Në shkresën që kemi marrë nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave në lidhje me këtë çështje thuhet se ky Projektligj nuk paraqet ndikime buxhetore, por më poshtë thuhet se dy elemente mund të jenë me ndikim buxhetor.

Nën një, autoriteti i rrugës publike dhe shtrohet pyetja pastaj, a është i njëjtë autoriteti i cili ka qenë i definuar në ligj, apo është autoritet tjetër. Sipas informacioneve del se ai është i njëjti autoritet që ka qenë i formuar në ligj dhe se nuk ka implikime buxhetore shtesë. Nëse është kështu, atëherë ai duhet të definohet më mirë në Projektligj.

Edhe te rezervat që i patëm në lidhje me ndikimin buxhetor, nën dy, që theksohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, thuhet se financimi, qeverisja, koncesioni, ndërtimi, rikonstruimi, mirëmbajtja, mbrojtja dhe mbikëqyrja e autostradës. Çështja si ajo e shpronësimit, duhet të kihet parasysh se ato duhet të bëhen në përputhje me Ligjin për shpronësim.

Çështja tjetër është çështja e gjobave. Shihet se derisa në ligj parashiheshin gjoba më të ulëta, në Projektligj propozohen ose ofrohen gjoba shumë më të larta. Për shembull, derisa për kundërvajtje me gjobë në ligj parashihej 25 €, këtu tash në Projektligj propozohen 2500 €. Në Projektligj del se për të njëjtat kundërvajtje kemi gjoba nga 5000 deri në 50.000 € dhe ne nuk e dimë arsyen se për çfarë fakti kemi gjoba kaq të larta. Këto jepen pa dhënë shpjegime shtesë. Edhe për ne shtrohet pyetja, se a thua kemi aq shumë kundërvajtje sa që duhet ta ngrisim edhe gjobën dhe duhet marrë masa shtesë më të rrepta, dënime më të larta e të tjera.

Pas korrigjimeve që do të bëhen në Komision, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike tash i jep mbështetje në parim. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në sallë kemi 72 deputetë. Fjalën e ka deputeti Mazllom Kumnova, në emër të AAK-së.

XHEVDET NEZIRAJ – Faleminderit! Me kartelën e Mazllom Kumnovës do të përgjigjem unë.

Projektligji në fjalë përkrahet edhe nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe nga ekspozea i ministrit u arsyetua se cilat ndryshime dhe cilat ndryshime të amendamenteve do të bëhen në këtë Projektligj. Gjithashtu, edhe komisioni funksional ka vlerësuar se duhet të bëhen ato ndryshime me qëllim të zbatimit më të mirë në praktikë të këtij ligji. Unë do të kisha veçuar se me anë të këtij ligji do të lehtësohet edhe puna e gjykatave për kundërvajtje, të cilat kanë adresuar një varg problemesh me ligjin e mëparshëm që nuk ka qenë i definuar ashtu siç duhet, e që besojmë se me ndryshimin e këtij ligji do të mundësohet që gjykatat ta kryejnë punë e tyre me më shumë sukses.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Aleancës përkrah dhe do të kontribuojë në leximin e dytë që ky Projektligj të jetë më i përsosur dhe i zbatueshëm në praktikë. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të ORA-s Gazmend Muhaxheri.

GAZMEND MUHAXHERI – Faleminderit, zoti Kryetar!

Arsyeja e ndërmarrjes së veprimit për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji qëndron në rritjen e efikasitetit në kryerjen e punëve të adresuara nga ky Projektligj. Me ndryshimet dhe plotësimet e propozuara të këtij Projektligji synohet të ndikohet pozitivisht në implementimin e Ligjit për rrugët. A thua çka e ka pengur Ministrinë e Transportit që deri më tani ta implikojë pozitivisht mbrojtjen e brezit rrugor, do me thënë, çka ndryshojnë ndryshimet e propozuara, me çka e rrisin efikasitetin e mbrojtjes së brezit rrugor.

Në nenin 25, ndryshimi i vetëm qëndron gjoba e cila është e paraparë që të jetë 100 mijë €, tani e tutje do të jetë prej 1000 deri në 50.000 € dhe asnjë veprim tjetër nuk është ndërmarrë që rrugët magjistrale dhe regjionale, me ndërtimet dhe atakimet që janë bërë për këto 4 vjet prej se është nxjerr Ligji për rrugët, të pengohen. I vetmi ndryshim, siç duket edhe arsyeja themelore për sjelljen e këtij Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët, qëndron në nenin 11, me të cilën Ministrisë i jepet e drejta që autostradën ta japë me koncesion.

Ne si Grup Parlamentar mendojmë që autostrada nuk mund të jepet me koncesion me vendim të ministrit, por ose duhet të jetë vendim i Qeverisë, ose vendim i këtij Kuvendi. Ajo çka është absurdi më i madh në këtë Ligj është se me nenin 12, e këtë po dua t’jua lexoj plotësisht, të këtij Projektligji, thuhet: “Lejen për ndërtimin dhe rikonstruktimin e autostradës, të rrugëve magjistrale dhe regjionale dhe të objekteve të tjera në këtë rrugë e jep Ministria.” Kjo do të thotë, zotëri të nderuar deputetë, se lejen për ndërtimin e spitaleve në të ardhmen do ta japë ministri i Shëndetësisë ose lejen për ndërtimin e shkollave e jep ministri i Ministrisë së Arsimit.

Ne si Grup Parlamentar japim përkrahje që Ligji duhet të ndryshohet, por jo këso ndryshimesh me të cilat bëhet përzierja e kompetencave dhe krijohen favore për dikë. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Për 6+ Mahir Yagcilar.

MAHIR YAGCILAR – Faleminderit, zoti Kryetar!

Saygıdeğer Meclis Başkanı, sayın bakanlar ve milletvekiller

6+ Parlamenter Grubu 2003/11 numaralı Yollara ait Yasanın değişme ve tamamlamalarına ilişkin Yasa Tasarısını özel ilgiyle inceledi.

Refakat mektubunda da ileri sürüldü gibi biz de bu Yasa önergesinin, yolların idare edilmesinde etkililiğin daha üst düzeye çıkarılmasını ve dolayısıyla Kosova'nın genel kalkınmasını körüklemeye yönelik olduğunu düşünüyoruz. Ayrıca bu değişmelerle, söz konusu alanda Avrupa Birliği ölçütlerine yaklaşmanın körükleneceğini, diğer taraftan şimdiye kadar geçerli olan Yasa ile kapsammayan bir alan olarak anayollarının da ele alınması olanağının sağlandığını düşünüyoruz.

Bundan başka, önerilen değişmelerin gerçekten gerekli olduğunu ve bu değişmelerle Yollara ait yeni Yasanın hayata geçirilmesi konusunda daha etkili ve işlevsel olacağını düşünüyoruz.

Bu genel olumlu değerlendirmeler yanı sıra, söz konusu Yasanın daha kaliteli ve titiz olması için real önkoşullar olduğunu da düşünüyoruz. Devamında sayacağım eksiklikler, Yasa Tasarısının daha iyi ve kusursuz olabileceğini kanıtlamaktadır.

İlk uyarım olarak, Yasa Tasarısında, örneğin “niteliksiz yol” tanımlamasında bu yolların kamu yollar sınıflandırılmasına girmedikleri ileri sürülürken, bu Yasa Tasarısının 2. maddesinde kamu yollar ağı çerçevesiyle niteliksiz yolların da kapsandığı gibi tutarsız tutumlar mevcut.

Bundan başka, Yasa Tasarısının 10. maddesi, yolların bakımına değinirken bu konu, bakımıyla ilgilenen bölüme değil, anayolların tasarlanması, inşaatı ve yapımını ele alan bölüme alınmış durumda.

11. madde doğrusu Yasanın 16.2 noktası yolların finansmanı, idare edilmesi, önceliklere sahip olması v.s. gibi konuların Bakanlığın altyasa akidleri ile ele alınması olanağını yaratmaktadır. Bize göre bu etkinlikler, yollara yatırımların yapılması ve devamlı bakımı ile inşaatı gibi konuların Yasa ile incelikli olarak ele alınması gerekmektedir.

Yasa tasarısının yolların inşaatına ait olan 13. maddesi daha doğrusu 19.1, 19.2 ve 19.3 noktaları, çevre korunumundan söz edilen 19.4 ve 19.5 noktaları önüne alınmış. Malesef, Yasa tasarısında, anayollar kavramının da ele alınması maksadı tam olarak amacına ulaşmamıştır, çünkü Yasa önergesinin 18 maddesi 26.1 noktasına alınması önerilmemiş, dolayısıyla Yollara ait Yasanın 27. ve 28. nokraları ile kapsammamıştır.

Müfettişlik bölümünde, inşaat denetimi ve karayolları denetimi ile ilgili tanımlamalar mevcut, bize göre bu olgu, denetim süresinde zorluklar yaratabilir.

Bundan başka cezalar bölümünde, örneğin bazı cezaların 2500'den hatta 5000'e kadar çıkarılması durumu şaşkınlık yaratmaktadır.

Yanı sıra 26. madde 36.1.c noktasında, ehliyeti olmadan özel taşıt işlerini yaptığı takdirde (ayraçlarda 28. madde) tüzel kişinin cezalandırılacağı ileri sürülürken, hemen ardındaki

d) noktada, ehliyet koşullarına dayanarak özel taşıt işlerini yapan tüzel kişinin cezalandırılacağı (ayraçlarda 28. madde) ileri sürülmektedir.

Sonunda bizim aramızda da, Kamu yolları Otoritesi kavramı, bu organın rolü ve Yasanın uygulanması için bütçe masrafları ile ilgili kavramlar pek ayan değil.

Sayın milletvekiller, yukarıda sözünü ettiğim zayıflıklar ve ayan olmayan konulara rağmen, Mecliste ilerideki süreçlerden geçtikten sonra bu Yasa tasarısının, daha kaliteli ve kabul edilir yapıya sahip olması için olanakların var olduğunu ve Mecliste ikinci okunuştan sonra kabul edilir hale geleceğine inanmaktayız.

Dikkatinize teşekkürler

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të LDD-së, Milazim Haliti.

MILAZIM HALITI – Zoti Kryetar,
Ministra të pranishëm,
Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët nr. 2003/11, i propozuar nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit dhe vlerëson se i njëjti është i nevojshëm që të miratohet nga Kuvendi sepse Ligji aktual ka disa mangësi dhe vështirësi gjatë zbatimit të tij. Ndryshimet e propozuara do të mundësojnë rritjen e efikasitetit dhe që punët e kësaj fushe të kryhen sa më mirë nga Sektori i Transportit të Ministrisë. Me këtë Projektligj synohet që të bëhen ndryshime dhe plotësime esenciale, ku nga 43 nene, sa ka ligji aktual, janë propozuar për amandamentim më se 21 nene. Me këto ndryshime të propozuara do të krijohen kushte më të mira për zbatim, ndërsa e veçanta e tij është çështja e trajtimit të autostradave, të cilat nuk trajtoheshin me ligjin në fuqi edhe kjo do të rregullohet me akte nënligjore të Ministrisë, si dhe është propozuar kreu i ri, Kreu VII, dënimet për kundërvajtje që i kanë munguar si kapitull i veçantë, do me thanë, termi “dënimet për kundërvajtje” që në masë të madhe ka pamundësuar zbatimin e dispozitave ndëshkimore.

Teksti i nenit 22 e plotëson dukshëm dhe e ndryshon nenin 30 të Ligjit me të cilën parashihet ruajtja, përkatësisht mosdëmtimi i rrugëve publike, ku parashihen më se 19 raste të ndalesave të ndryshme që ndikojnë drejtpërsëdrejti në mosdëmtimin, respektivisht në ruajtjen e rrugëve publike.

Sa u përket propozimeve të masave të reja ndëshkuese, përkatësisht dënimeve për kundërvajtje, ne mendojmë se propozimet e bëra janë shumë të larta që mund të vejnë në pikëpyetje edhe zbatimin e tyre, siç është neni 25, ku parashihet dënimi për kundërvajtje prej 5000 deri në 50.000 €, i cili nen plotëson nenin 34 të Ligjit që parasheh dënimin prej 25 deri 2500 €. Si rast i dënimit për kundërvajtje në këtë lartësi është paraparë edhe rasti kur pronari i automjetit të mbingarkuar që lëviz në një rrugë publike pa leje të veçantë, do të thotë, do të dënohet deri në 50.000 €. Ndërsa, për të njëjtin rast, neni 27 parasheh dënimin prej 5000 deri 15.000 € që në këtë rast do të shkaktohet një konfuzion, që do të thotë se duhet të korrigjohet pika c) e nenit 25 ose pika b) e nenit 27.

Besojmë se Komisioni Funkcional, gjatë procedurës së amandamentimit, do të ketë parasysh këto vërejtje dhe vërejtjet e tjera që duhet të korrigjohen në mënyrë që të kemi një Projektligj më të kompletuar dhe më të përshtatshëm për implementimin e tij.

Duke vlerësuar rëndësinë e ndryshimeve dhe të plotësimeve të Projektligjit, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e përkrah në parim miratimin e Projektligjit në fjalë dhe do të kontribuojë në procedurën e mëtutjeshme të amandamentimit. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Në emër të Grupit për integrim, Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ – Prvo, pozdravljam skup, Predsednika, ministra i gospodu poslanike,

Nacrt zakona o izmenama i dopunama Zakona o putevima br. 2003/11 razmotrili smo jako pažljivo kao Grupa za integraciju. Sam Nacrt zakona o putevima je u stvari deo Nacrta zakona o putevima, o dopunama, deo je Nacrta zakona o putevima koji smo imali prethodno, koji smo usvojili ovde u Skupštini.

Predloženim amandmanima dopunjuje se pravna infrastruktura istog Zakona, kako bi bili spremni za ispunjavanje kriterijuma koji su predviđeni zakonom Evropske unije. Nacrt zakona 2003/11 se postavlja kao osnova za javnu politiku razvoja drumske infrastrukture na Kosovu za brže integrisanje na regionalnim i evropskim mrežama. Nacrt zakona ima svoju strukturu opisanu u 8 poglavlja. Jako važno I poglavlje sa opštim odredbama, takođe IV Poglavlje o izgradnji i rekonstrukciji, V Poglavlje o vrstama korišćenja puteva i VII Poglavlje daje precizno kazne i prekršaje na ime Nacrta zakona 2003/11.

Nacrt zakona po drugi put opisuje vrste puteva, tojest definiše kategorizaciju puteva na Kosovu, i vidimo da su to: autoputevi, magistralni putevi i regionalni putevi. Ove tri vrste puteva su u ndaležnosti Ministarstva za saobraćaj, dok imamo vrstu lokalnih puteva i nekategorizovanih puteva i ove druge dve vrste su nadležnosti samih opština. Opisane su i sve vrste izgradnje i rekonstrukcije svih ovih vrsta puteva na Kosovu i autoriteta koji su nadležni da izvršavaju iste poslove za potrebe projekte izgradnje, rekonstrukcije i održavanje javnih puteva i to u saradnji Ministarstva za saobraćaj i Ministarstva sredine i prostornog planiranja.

Na kraju, u VII Poglavlju određene su kazne za pravna i fizička lica koja neće poštovati odredbe Nacrta zakona kadu su u pitanju radovi i izgradnja koja ometa puteve. Odredbe zakona su namenske i želimo da što pre počnu da se sprovode na terenu. Hvala!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Meqë nuk ka të tjerë të interesuar për diskutim, le të votojmë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Në sallë janë të pranishëm 78 deputetë.

Me **67 vota** “për” dhe asnjë “kundër”, konstatoj se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët.

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organizimin e institucioneve të kadastrit

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 1 gusht 2007 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin e tij, në parim.

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media si komision funksional dhe raportues, ka bërë shqyrtimin paraprak dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj ministren Milihate Tërmkolli që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve ta prezantojë Projektligjin në fjalë. Urdhëroni ministre!

MINISTRJA MELIHATE TËRMKOLLI - I nderuari zotëri Kryetar,
Të nderuar deputetë,

Them që ky Projektligj rregullon, pra, organizimin e institucioneve të kadastrit në Kosovë. Në fakt, mund të them që me Projektligj rregullohet organizimi i ri i institucioneve të kadastrit nga se organizimi aktual nuk ka ofruar funksionim të mirëfilltë ligjor të kadastrit dhe lë shumë hapësirë për konfuzitet dhe parregullshmëri të mëdha në punën e këtyre institucioneve.

Është e qartë se kadastrit dhe shërbimet që ofrojnë këto institucione kanë rëndësi për qytetarët dhe të drejtat e tyre themelore, siç është e drejta pronësore, por kjo ka rëndësi të veçantë edhe për zhvillimin e vendit në fushën që lidhet me hipotekat, kreditë, sigurinë dhe rregullshmërinë e të drejtave pronësore dhe çështje të tjera. Është vërejtur dhe është vlerësuar se institucioni qendror i kadastrit, Agjencioni Katastral i Kosovës, ka zbrastësi të theksuara në funksionimin e tij, ndërsa ka papërputhshmëri dhe laramani të mëdha të cilat janë vërejtur në funksionimin e zyrave komunale të kadastrit. Kjo ka shtuar domosdonë për organizim ndryshe, pra, të këtyre institucioneve dhe funksionim më efikas të tyre.

Me këtë Projektligj është paraparë një lidhshmëri më e madhe dhe harmonizim i funksionimit të zyrave komunale të kadastrit me Agjencionin Kadastral të Kosovës. Me këtë, pra, Agjencioni Kadastral i Kosovës do të merret me organizimin e institucioneve të kadastrit dhe merr përgjegjësinë për funksionimin e kadastrit në Kosovës, sigurinë e të dhënave kadastrale, garantimin e të drejtave nga lëmi i paluajtshmërive dhe çështje të ngjashme.

Me këtë Projektligj krijohen kushte për integrim të kadastrit të Kosovës në institucionet ndërkombëtare nga lëmi i regjistrimit të të drejtave mbi pronën e paluajtshme dhe lëmi i kadastrit nga se është Projektligj që përmbush standardet ndërkombëtare në këtë fushë dhe gjithsesi me këtë Projektligj krijohen kushtet për shërbime më cilësore për qytetarët, institucionet qeveritare dhe subjekte të tjera.

Në Projektligj, pra, përcaktohen organet kompetente për kadastrë, themelimi i tyre, kompetencat, organizimi territorial dhe udhëheqja e tyre. Sipas kësaj, Agjencioni Kadastral i Kosovës përcaktohet si institucion qendror përgjegjës, ndërsa zyrat komunale kadastrale përcaktohen si njësi të Agjencionit Kadastral të Kosovës si nga pikëpamja

organizative, ashtu edhe nga pikëpamja financiare buxhetore. Mund të them se Projektligji është në harmoni me standardet ndërkombëtare për këtë fushë dhe, gjithsesi, ajo që nuk ka implikime buxhetore në zbatimin e tij.

Kërkoj, deputetë të nderuar, që ky Projektligj të miratohet në leximin e parë dhe, gjithsesi, me kontributin e juaj të përplotësohet gjatë fazës tjetër deri në miratimin e tij të plotë në Parlamentin e Kosovës. Faleminderit shumë!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, zonja ministre! Ftoj kryetaren e komisionit funksional Nekibe Kelmendi, ta marrë fjalën.

NEKIBE KELMENDI - I nderuari zoti Kryetar,
Të nderuar ministra dhe ju deputetë,

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, duke i shfrytëzuar rregullat e reja të Rregullores për Punën e Kuvendit që edhe para miratimit, në lexim të parë t'i shqyrtojë ligjet që bëjnë pjesë në fushëveprimin e këtij Komisioni, apo në rastet kur ky Komision është funksional, e ka shqyrtuar Projektligjin në fjalë dhe ka marrë qëndrim që të rekomandohet që Kuvendi i Kosovës t'ia kthejë Qeverisë këtë Ligj për këto arsye.

Ky Ligj përmban gjithsej 9 nene. Neni 1 ka të bëjë me qëllimin e Ligjit, neni 2 ka të bëjë me përkufizimin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Përkufizimi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës është i rregulluar me Ligjin për kadastrë, neni 2.16, 2.17 dhe 2.14.

Neni 3, statusi i institucionit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe i zyrave kadastrale komunale, gjithashtu është i rregulluar me Ligjin për kadastrin, por edhe me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/45, sipas të cilës komunat e bëjnë organizimin e brendshëm të tyre dhe caktojnë drejtoratet të cilat do të veprojnë në kuadër të tyre. Komunat kësaj radhe, me statutet e tyre, po edhe me rregulloren e cituar, janë përcaktuar që në kuadër të Agjencisë kadastrale të funksionojë edhe Drejtorati për Pronë, Agjencia kadastrale dhe të formohen për këtë qëllim edhe zyrat kadastrale. Zyrat kadastrale janë të themeluara në të gjitha komunat e Kosovës, të cilat janë të përmendura në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/2005.

Autorizimet dhe përgjegjësitë e Agjencisë kadastrale të Kosovës dhe të zyrave të kadastrave që janë rregulluar me nenin 3 të Projektligjit janë të rregulluara me Ligjin për kadastrin, nenin 3, 4 dhe 5. Themelimi i zyrave kadastrale komunale dhe themelimi i zyrave të reja kadastrale komunale është rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut, siç thashë, për vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/2005. Ky është neni 6 i Projektligjit që po e shqyrtojmë.

Punëtorët dhe mjetet e punës të drejtorive komunale për gjeodezi dhe kadastrë, janë punëtorë dhe mjete të punës të drejtorive komunale për gjeodezi dhe kadastrë, sepse këto janë organe komunale, (neni 32 i Ligjit për kadastrin).

Nxjerrja e udhëzimeve administrative është e rregulluar, gjithashtu, me Ligjin për kadastrin dhe është kompetencë e Ministrisë për Shërbime Publike, përkatësisht e ministres për Shërbime Publike që të nxjerrë udhëzime administrative mbi çështjet të cilat mund të rregullohen me akte nënligjore.

Përcaktimi i organeve kompetente për kadastrë në Kosovë është i rregulluar me Ligjin për kadastrin, nenin 3, 4, 5, 7, 8, 20 dhe 30 dhe me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, neni 3.3 e tjera. Prandaj, meqë çështjet e kadastrave, përkufizimet, përgjegjësitë dhe kompetencat, organizimi, punëtorët dhe mjetet e punës, nxjerrja e udhëzimeve administrative janë rregulluar me Ligjin për kadastrin, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/4 datë 18 shkurtë 2004, i cili Ligj tash për tash është i aplikueshëm deri në nxjerrjen e Ligjit për ndryshimin e tij, dhe me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, e duke qenë se me këto zgjedhje që janë bërë me Projektligjin e cituar është bërë vetëm dyfishimi i zgjidhjeve të cilat janë bërë me ligjet e cituara, Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media i rekomandon Kuvendit të Kosovës që Projektligji për organizimin e institucioneve të kadastrit t'i kthehet propozuesit, Qeverisë së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Nga LDK-ja profesor Gashi. Urdhëroni!

ALUSH GASHI – Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i kushton vëmendje të posaçme organizimit të institucionit të kadastrit dhe me tërë kapacitetet e veta i jep mbështetje rregullimit të kësaj çështjeje në mënyrën më të mirë ligjore. Ne me shumë kujdes e kemi shqyrtuar këtë tekst dhe në bashkëpunim me komisionin funksional kemi ardhur në përfundim se kërkesa e këtij komisioni është e drejtë dhe presim që komisioni funksional të bashkëpunojë, t'i bashkërendojë veprimet me Ministrinë përkatëse, si propozues, dhe në një afat sa më të shkurtër ta zgjidh këtë çështje, e cila do të jetë në të mirë të qytetarëve të Kosovës dhe kjo çështje të rregullohet, ashtu siç duhet, me ligj. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të PDK-së, prof. Nerxhivane Dauti.

NERXHIVANE DAUTI – Faleminderit, zoti Kryetar!
Të nderuar kolegë deputetë, ju përshëndes të gjithëve,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë ligj me vëmendje të madhe dhe gjatë shqyrtimit të Projektligjit për organizimin e institucioneve të kadastrit ka konstatuar se organizimi i institucioneve të kadastrit është i rregulluar me Ligjin për kadastrin 2003/25 dhe Rregulloren e UNMIK-ut mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës 2000/45 dhe me miratimin e këtij Projektligji do të bëhet duplikimi i dispozitave ligjore në fuqi. Duke u bazuar në këto arsye, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah rekomandimin e komisionit funksional, pra të Komisionit për Shërbime Publike, që Ligji t'i kthehet propozuesit, Qeverisë së Kosovës në shqyrtim. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! në emër të AAK-së Mazllom Kumnova.

MAZLLOM KUMNOVA – Grupi jonë mendon që, përkundër kësaj, t'i hapet rrugë këtij Projektligji meqë me të sigurohet themelimi i dy institucioneve shumë të rëndësishme. Kaq!

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit! Në emër të ORA-s, Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA – I nderuari Kryetar i Kuvendit,
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi ynë Parlamentar e ka shqyrtuar këtë Projektligj për kadastër me kujdes të veçantë dhe është konsultuar me ekspertë të kësaj lëmie dhe nga këto konsultime ka dalë që Ligji ekzistues për kadastër dhe Rregullorja e UNMIK-ut në një mënyrë e kanë rregulluar këtë çështje, por, sidoqoftë, është evidente që gjatë funksionimit, gjatë përdorimit të këtyre ligjeve janë evidentuar mangësi dhe janë evidentuar zbrastësi në funksionimin e këtyre zyrave komunale në ndërlidhje me zyrat qendrore. Prandaj, sa kemi mundur të shohim edhe prej diskutimeve të mëhershme, këto mungesa, këto zbrastësi janë evidente dhe ato duhet të rregullohen. Në qoftë se komisioni funksional ka marrë parasysh rekomandimin që ai të kthehet, mendoj që duhet të kihet parasysh që ato mungesa të cilat ekzistojnë, ato zbrastësi, të rregullohen në mënyrë që të jenë sa më funksionale këto zyra dhe të kenë atë hierarkinë e ndërlidhjes me Zyrën qendrore dhe të mos jetë si tash që inxhinierët e kadastrës duhet të licencohen, të mbikëqyren, të inspektohen prej inxhinierëve të ndërtimtarisë apo të makinerisë, por të jetë një hierarki vertikale që do të sigurojë një funksionim më të mirë. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të Grupit 6+ Shpresa Murati.

SHPRESA MURATI - Hvala! Parlamentarna grupa 6+ takode podržava preporuku funkcionalne Komisije za javne službe, lokalnu administraciju i medije da se Nacrt zakona o organizovanju institucija katastra Kosova vrati Vladi, odnosno predlagaču. Hvala!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të Grupit LDD, Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI – Ju faleminderit!

Grupi i LDD-së e ka shqyrtuar, po ashtu, këtë Propozimligj për organizimin e institucionit të kadastrës dhe duke u mbështetur në argumentet e prezantuara këtu, edhe ne i përkrahim rekomandimet e komisionit funksional. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Grupi për Integrim? S’ka. Ministria Melihate Tërmkolli e ka fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI – Po, natyrisht, me shumë respekt për qëndrimin e komisionit parlamentar për këtë çështje, por megjithatë dua t’i paraqes disa shpjegime këtu në Parlamentin e Kosovës, sepse nuk do të dëshiroja që Parlamenti i Kosovës të marrë përgjegjësinë për çështjet për të cilat, thjesht, nuk do të duhej të merrte përgjegjësi. Në fakt, është Parlamenti i Kosovës që do të duhej t’i luftonte ato gjëra, të cilat po ndodhin në Kosovë dhe jo të jetë një mbështetës, apo një kreator i shumë veprimeve, të cilat janë të dëmshme për vendin dhe për qytetarët e Kosovës. Së pari, unë mendoj që ndoshta nuk është kuptuar drejt esenca e Projektligjit. Projektligji nuk po e dyfishon rregullimin e kadastrës. Është e vërtetë që ka ligje për kadastër, është rregulluar në një formë. Projektligji i ri ka një organizim të ri të kadastrës. Ne po flasim për një

rregullim të ri, për një formë të re të rregullimit të kadastrës dhe në asnjë mënyrë nuk është kjo një dyfishim ose një përsëritje e asaj që është në ligjet e mëparshme, sepse po flasim për funksionimin e një agjencie ndaj së cilës do të jenë përgjegjëse zyrat komunale të kadastrës, do të jenë njësi të kësaj agjencie dhe në funksion të shtimit të përgjegjësive, ngase gjendja aktuale është tepër e rëndë, për të mos thënë alarmante. Është gjendje alarmante në institucionet e kadastrës së Kosovës. Është gjendje alarmante në një pikë tepër të ndjeshme për zhvillimin e vendit, në një pikë tepër të ndjeshme për Kosovën dhe në një pikë, e cila nuk duron më tutje parregullsi të këtij lloji çfarë janë. Unë e di që kjo rregullohet edhe me Rregulloren e organizimit lokal, me Ligjin për kadastrën e të tjerë, por kjo ka shtruar nevojën që ky rregullim i deritanishëm nuk është treguar funksional dhe kjo mënyrë, thjesht, duhet të ndërpritet. Ne kërkojmë një formë dhe një mënyrë të re të organizimit, pavarësisht këtyre rregullave të UNMIK-ut që janë, për ta bërë këtë institucional, më funksional dhe më të përgjegjshëm ndaj institucioneve, ndaj qytetarëve edhe çështjes me të cilën merret realisht.

Së pari, unë kujtoj që kjo ka qenë në strategjinë legjislative dhe nuk është mirë që Parlamentit, pas sa muajve, pas sa viteve, t'i kujtohet që duhet të hiqet. Mua më vjen keq, por thjesht ka qenë në strategjinë legjislative kur ky Parlament e ka parë këtë.

E dyta, pra e thashë, është një ndryshim esencial. Nuk është fjala për përsëritje. Absolutisht. Mund të ketë ndonjë përsëritje që nuk e përjashtoj. Mund të jetë ndonjë rregull etj., që ka qenë e domosdoshme për ta funksionalizuar këtë ligj. Por, absolutisht nuk është çështja për përsëritje. Është fjala për një ligj që rregullon në mënyrë të re organizimin e kadastrës të Kosovës. U përmend diku, jo i kanë zyrat komunale, të drejtat, ndoshta dikujt po i dhemb pak a shumë edhe çështja e decentralizimit etj. Decentralizimi është ofrim i shërbimeve qytetare, jo ofrim i kompetencave. Ju lutem shumë, nëse lejojmë që kompetencat kanë për t'u shtruar nga secila zyrë komunale në mënyrë të veçantë, atëherë e kemi shumë parasysh se çfarë do të ndodhë me këto institucione. Pra, absolutisht ne jemi për te ofruar shërbime sa më afër qytetarëve dhe këto shërbime ofrohen me këtë ligj përmes zyrave komunale që veprojnë si njësi të kadastrës, por jo si kompetencë, sepse në fakt kjo gjendje aktuale që u lejon kompetencë, thjesht ka krijuar një kaos në institucionin e kadastrës dhe këtë Qeveria e Kosovës, Parlamenti i Kosovës, unë besoj, që nuk mund ta lejojë më tutje.

Së dyti, kemi edhe raste të tjera që kemi një organizim tjetër, përkundër rregulloreve të UNMIK-ut. Ne kemi Ministrinë e Brendshme, po e zëmë, që të punësuarit që kryejnë shërbime të caktuara të dokumentacionit e tjerë, tashmë janë punëtorë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ani pse kanë pasur statusin e njësive edhe ato komunale etj. - kështu që nuk është ndonjë gjë krejt e veçantë që s'ka ndodhur dhe s'po ndodh në Kosovë.

Një pikë tjetër shumë e rëndësishme, është ky ligj, të cilin e kemi vënë po ashtu në konsultim me mekanizmat ndërkombëtarë. Ky ligj është kusht, në fakt zbatimi i tij, sepse edhe ligji më i mirë nuk vlen nëse nuk zbatohet. Miratimi i tij do të jetë një parakusht për Kosovën dhe integrimin e saj në strukturat ndërkombëtare, në institucionet ndërkombëtare. Prandaj, unë nuk do t'ia jepja vetes këtë përgjegjësi që të bllokohet kjo çështje dhe thjesht me lehtësinë kaq të madhe të anulohet dhe të thuhet - kthehet etj.

Një pikë tjetër. Ne natyrisht, të gjitha ligjet, apo shumicën e tyre, e kemi bërë dhe e bëjmë pak a shumë duke u mbështetur edhe në përvojat e vendeve të tjera dhe në veçanti

ato që kanë një nivel të zhvillimit dhe që janë pranuar ose janë në rrugën e pranimit në Bashkimin Evropian. Ky ligj nuk është përjashtim nga asnjë tjetër. Domethënë, ka një përputhshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare dhe thjesht është një model nga vendet të cilat janë të pranura ndërkombëtarisht në kuptimin e funksionimit të kadastrës si fushë.

Edhe një çështje tjetër. Me rregullimin aktual, ky kadastrë është një burim i madh i korrupsionit në Kosovë. Fatkeqësisht janë të lidhura shumë interesa. Fatkeqësisht këtu s' janë të përjashtuar edhe zyrtarë, apo të mos them janë të parët zyrtarët që janë të hidhur me ato interesa. Dhe, më vjen tepër keq që janë dy ligje, që është shumë indikativ, që lidhen me çështjen e paluajtshmërive dhe drejtave pronësore që refuzohen nga ky Parlament. Unë nuk do të doja asnjëherë që Parlamenti të marrë përgjegjësi të tillë. Është çështje tjetër, janë argumente të tjera, por kujtoj që argumentet më të mëdha shkojnë në funksion të miratimit të këtij projektligji. Më falni, me këtë laramani që është, secilës zyrë komunale të kadastrës, ndoshta edhe Zyrës Qendrore, i teket që, në emër të ofrimit të shërbimit publik që e ka detyrë që ta ofrojë atë shërbim, çohet dhe ia mohon atë të drejtë qytetarit, shkon edhe në mënyrë private diku 50 € diku 100 € etj. sepse nuk i jep përgjegjësi askujt. Është një punëtor aty, i cili kryen një pjesë të punëve dhe nuk është përgjegjës ndaj askujt.

Prandaj, kjo ka qenë një nga arsyet që të bëjmë një formë të re dhe një mënyrë të re që ajo agjenci e Kosovës të marrë përgjegjësinë e rregullimit të punëve në institucionet komunale të kadastrës dhe, si e tillë, unë kujtoj - sigurisht e ka arsyen e vet të plotë.

Unë nuk di kujt po i pengon rregullshmëria në kadastrë. E di se Parlamentit të Kosovës jo. Mund t'i pengojë, ndoshta ndonjë individ brenda në Parlament të Kosovës!? Fatkeqësisht mund të jenë ato interesa krejt personale. Dikujt, ndoshta, edhe i ndalet puna pak, me një rregull më të madh në institucionet e kadastrës. Mirëpo, kjo nuk bën t' i pengojë Parlamentit të Kosovës, sepse janë interesa më të mëdha të qytetarëve të Kosovës dhe ju lutem shumë, abstenoni një herë, si individ po flas, nuk flas për Parlamentin. Ka ndonjë deputet këtu. Abstenoni një herë në jetën tuaj interesat tuaja personale në dobi të interesave të Kosovës dhe të qytetarëve të saj dhe ju lus ta miratoni projektligjin. Ju faleminderit shumë!

Edhe një çështje tjetër. Është një rregull në Parlament, që kur shqyrtohen këto ligje të ftohet Ministria, të ftohen zyrtarët e Ministrisë. Mua më vjen shumë keq që ndoshta jam prej ministrave që vazhdimisht kam shprehur vullnetin për të marrë pjesë në punën e komisioneve parlamentare. Ndodh që për të krijuar një alibi për ta sulmuar ministrin, nganjëherë ftohen ministrat, që dihet paraprakisht që nuk vijnë. Unë në këtë rast nuk jam ftuar. Nuk është ftuar as një zyrtar i Ministrisë së Shërbimeve Publike, me rastin e trajtimit të kësaj. Unë kujtoj që ka qenë e rrugës, ka qenë e domosdoshme që të ftohen, të trajtohen këto çështje, të bisedohet për këto dhe jam shumë e sigurt do të kishte një qëndrim krejtësisht tjetër. Pse nuk e ka bërë Komisioni këtë, unë sinqerisht nuk e kam të qartë? Sa herë më kanë ftuar, kam shkuar. Ndoshta kjo është mangësia ime, ndonjëherë duhet të abstenoj, për t'më ftuar. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI- U përmend nga zonja ministre se nuk janë funksionale zyrat e kadastrave. Është e vërtetë se nuk janë funksionale, por duhet shikuar cila është arsyeja pse ato nuk janë funksionale. Nuk janë funksionale që tetë vjet, sepse krejt lënda e

kadastrave të Kosovës, sidomos e Prishtinës, që është gjysma e Kosovës, është në Krushevc. Qytetarët tanë për ta marrë një manual, një historiat të pronës, një dokument tjetër, duhet të shkojnë të paguajnë 2000 € atje. Do të ishte shumë më mirë që Qeveria të angazhohet nëpërmjet UNMIK-ut që ajo lëndë kadastrave t'i kthehet Kosovës dhe të funksionojnë si duhet zyrat e kadastrave, kështu si janë të organizuara, e jo të flasim ne këtu për korrupsion. Korrupsioni më i madh bëhet në Krushevc, sepse drejtori i kadastrës të Prishtinës ende funksionon si zyre paralele e kadastrës së Prishtinës në Krushevc. Kjo është nën l.

E dyta, sa i përket korrupsionit këtu, nuk është qëllimi i ligjit që na është prezantuar sot që të luftohet korrupsioni. Korrupsioni luftohet me Kodin Penal të Kosovës dhe korrupsioni luftohet nga organet e ndjekjes, po edhe me bashkëpunimin e qytetarëve, nëse i paraqesin rastet korruptive.

Sa i përket interesave personale, t'ju them sinqerisht, është fyerje jashtëzakonisht e madhe ndaj meje, sepse unë më së paku kam punë me kadastër ose fare nuk kam punë me kadastrën, edhe pse e ushtroj profesionin e avokatit.

Duhet të dëgjojë e gjithë popullata e Kosovës se kam sakrifikuar edhe njerëz e edhe financiarisht po e ndihmoj ndërtimin e shtetit të Kosovës. Nuk jam ajo që punoj për interesa personale.

(Ndërhyrja e kryetarit) – Nuk të është përmendur emri)

NEKIBE KELMENDI - Është aluduar në mua, ju lutem, zoti kryetar! Taman puna, nëse kolegeja thotë: Nekibe Kelmendi, avokate, ka interes. Le ta argumentojë kur, dhe pse, e manifestova atë interes? Le t'i punojë më mirë ligjet. Asnjë ligj nuk do të kthehet. I ka edhe dy ligje të tjera, apo ka pasur edhe ligje të mëparshme. Natyrisht, gjatë dy legjislativave, të ndodhë që dy ligje të kthehen, nuk është kjo kiamet e madh. Këto ligje mund të përpunohen më mirë dhe t'i kthehen Kuvendit dhe ai do të vendosë për to. Por, nuk është mirë që Qeveria t'i kërcënohet Kuvendit dhe t'i thotë atij është në përgjegjësinë tuaj nëse nuk kalon ky ligj. Kurrë Qeveria nuk e ka kontrolluar Kuvendin, por përkundrazi, Kuvendi është ai që kërkon llogari prej Qeverisë. Kjo është përgjigjja ime shumë e shkurtër. Kam mund të flas edhe më gjatë. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tash për miratim në parim:

Për..... 25,
Kundër.... 30.

Me 25 vota “për” dhe 30 “kundër”, nuk miratohet ky Projektligji.

Pika e pestë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve më 9 gusht 2007 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Ftoj ministrin Ardian Gjini, që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin. Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI ARDIAN GJINI – Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Sot para jush e paraqes Projektligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis, vlerësim i cili, edhe deri më tani, është bërë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mirëpo përmes një rregulloreje.

Qëllimi i ligjit është parandalimi ose zvogëlimi i ndikimeve negative në mjedis të projekteve të propozuara nga aplikuesi, qofshin ato projekte industriale, komerciale apo edhe infrastrukturore.

Ligji për VNM është i nevojshëm për të rregulluar procedurat për identifikim, vlerësim, raportim, administrim dhe ndikimet mjedisore të një projekti të propozuar, me qëllim që të sigurohet konsiderimi i plotë i të gjitha informatave relevante mjedisore para implementimit të projektit. Ky ligj është në përputhje me rregulloret evropiane të kësaj fushe dhe së bashku me aktet nënligjore, që do të pasojnë, do të ofrojë harmonizim të plotë të elementeve tona legjislative për vlerësimin e ndikimit në mjedis me rregulloret evropiane ose rregullativat evropiane.

Projektligji është i ndarë në strukturë si vijon. E ka kreun e parë, ku paraqiten, si zakonisht, dispozitat e përgjithshme, qëllimi dhe lënda, rregullimi i këtij ligji, përkufizimet dhe emërimi i autoritetit kompetent.

Në kreun e dytë përcaktohen projektet që do t'i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe detyrimet e aplikuesit për pëlqimin mjedisor dhe detyrimet e Ministrisë ndaj aplikuesit.

Në kreun e tretë trajtohen çështjet për procedurat e vlerësimit në mjedis, fazat e procedurës së VNM-së, kërkesat për fillimin e procedurës së VNM-së dhe shqyrtimit të saj, udhëzimin e studimit dhe studimin - raportin e VNM-së për mbajtjen e përpiluesit dhe shqyrtimin e këtij raporti etj.

Në kreun e katërt përcaktohen rregullat për informim dhe pjesëmarrje të publikut, ndikimet ndërkufitare, arkivimi i dokumentacionit, qasja në dokumentacion dhe mbikëqyrja e atij dokumentacioni.

Në kreun e pestë përcaktohen rregullat dhe dispozitat ndëshkuese të kundërvajtjes.

Në kreun e gjashtë paraqiten dispozitat përfundimtare dhe kalimtare, që kanë për qëllim përcaktimin e afatit për nxjerrjen e akteve nënligjore, zgjidhjen e kërkesave të paraqitura më parë, ndërprerjen e vlefshmërisë së rregulloreve të mëparshme, si dhe hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Ligji, po ashtu, i ka edhe tri shtojca. Shtojca e parë ka të bëjë me projektet, të cilat janë subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis, do të thotë radhiten.

Në shtojcën e dytë, radhiten projektet e përcaktuara në shtojcën 2- projekte të cilat do të shqyrtohen rast për rast, që nuk janë në listë.

Shtojca 3 ka të bëjë me kriteret e përzgjedhjes së projekteve, të cilat realisht radhiten në shtojcën dy.

Unë e lus Kuvendin e Kosovës që ta miratojë në parim këtë ligj dhe gjatë kohës sa do të shqyrtohet nëpër komisione dhe gjatë punës në Kuvend, dhe se ekspertët e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të jetë në gjendje gjatë gjithë kohës të bashkëpunojë me ju. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike? Naxhije Doçi, sigurisht në emër të LDK-së, apo Shaban Halimi, në emër të LDK-së.

SHABAN HALIMI – Ju faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar kolege e kolegë deputetë,

Projektligji në fjalë ka qenë në rend të ditës në seancën plenare të 31.5.2007 dhe ky projektligj i është kthyer sponsorit, me qëllim të plotësimit më të mirë dhe, gjithashtu, të harmonizimit me Zyrën Ligjore të Bashkësisë Evropiane, gjegjësisht të Agjencisë për Integritet Evropiane. Në këtë drejtim, domethënë, anëtarët e Komisionit të Grupit Parlamentar të LDK-së e kanë shqyrtuar këtë projektligj dhe kemi parë se projektligji është i plotësuar, sidomos me pjesën shtesë - shtojcën e parë, të dy të dhe të tretë, që janë elemente shumë të rëndësishme të këtij projektligji. Gjithashtu, krahasuar me ligjin e parë që ka qenë në seancën e parë ka edhe nene më tepër dhe do të thotë se edhe neni 6 është nen i shkurtër që edhe më tepër e qartëson fushëveprimin e këtij ligji.

Mirëpo, anëtarët e Komisionit funksional të Grupit Parlamentar të LDK kanë vërejtur se është bërë një lëshim, që konsideroj se mund të jetë teknik, ku deklarata e pajtueshmërisë me legjislacionin evropian është deklarata e njëjtë e ligjit të parë, në të cilën thuhet se “ky ligj nuk është në përputhshmëri me ligjet e Bashkësisë Evropiane”.

Shpresoj se kjo mund të rregullohet edhe nga ana e Ministrisë, prandaj Grupi Parlamentar i LDK-së do ta ketë votën e vet pro leximit të parë dhe besoj se si anëtarë të Komisionit funksional do të japim kontributin tonë që ky ligj të jetë edhe më i plotësuar. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputetja Selviqe Halimi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

SELVIQE HALIMI – Ju faleminderit zoti kryetar,

Partia Demokratike e Kosovës ka shqyrtuar këtë projektligj edhe herën e parë kur ka ardhur në seancë dhe ministri e ka tërhequr pas vërejtjeve që janë dhënë para saj të lexohet edhe herën e dytë.

Mendojmë se lëshimet teknike që vazhdimisht po bëhen nëpër ligje dhe kur ato përsëriten, faktikisht tregojnë një moskujdes për përmirësimin e punës së atyre të cilët punojnë në grupet punuese dhe të atyre të cilët i dhënë dorën e fundit një ligji që vjen për miratim në Kuvendin e Kosovës.

Megjithatë, që të mos u marrë kohë deputetëve, me vërejtjet dhe mospërputhshmërinë në mes paragrafëve në këtë ligj, të cilat besoj se do të shqyrtohen gjatë Komisionit, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, në parim e përkrah këtë ligj dhe tërheq vërejtjen se gjatë punimit në Komision duhet të bëhet një analizë më e thuktë në mes kompetencave të cilat mund të delegohen në komuna, sa i përket vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe atyre që do të mbesin në kompetencë ekskluzive të Ministrisë së Mjedisit. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të AAK-së Mazllom Kumnova.

MAZLLOM KUMNOVA – Aktualisht gjendja në mjedis është shqetësim i mbarë njerëzimit. Këto shqetësime janë edhe në Kosovë, kuptohet. Prandaj, çdo ligj, akt nënligjor, ose nismë tjetër që ka të bëjë me çështje mjedisore është jo vetëm e mirëpritur nga grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, por shprehim edhe një gatishmëri për të kontribuar. Nevoja për afrimin e ligjeve tona me standardet e kërkuara ndërkombëtare dhe në fushën e mjedisit, është pjesë e angazhimeve të institucioneve tona.

Edhe ky projektligj që sot e kemi në dorë, ka qëllimin e caktuar ose hartuesi ka bërë përpjekje që të merren me parandalimin, ose me uljen e ndikimeve negative në mjedis, dukuri kjo në Kosovë, në përmasa shqetësuese.

Sa jemi të informuar, ky projektligj duhet zërë hapësirën ligjore të një udhëzimi që aktualisht është në fuqi. Përveç tjerash, ky projektligj njëherë është tërhequr nga ministri Gjini për shkak të mangësive, të cilat, më sa duket, janë plotësuar deridiku. Mirëpo, edhe gjatë shqyrtimit të projektligjit kemi konstatuar disa vërejtje si vijon. E para, se Agjencia për Integrimin Evropian ka shënuar si vërejtje se projektligji nuk ka përmbushur në tërësi sidomos kërkesën e Aqua komunitare por besoj se gjatë procedurës të Komisionit duhet përmbushur kjo kërkesë.

E dyta. Projektligji ka anashkaluar plotësisht institucionet e nivelit komunal në këtë proces, si institucione që duhet të lëshojnë lejen e ndërtimit- p.sh. pas marrjes së pëlqimit mjedisor.

Neni 11, pika 5, akoma më shumë e megjullon rolin e komunës në tërësinë e këtij procesi të pëlqimit mjedisor. Prandaj, shtrohet çështja, a mund komuna të rifillojë procesin e VNM-së nëse Ministria ka konstatuar se një gjë e tillë nuk kërkohet. Pa dyshim, kjo kërkon një qartësim.

E treta. Në nenin 16, pika 1 thuhet: Raporti i VNM-së hartohet nga personi fizik ose juridik. Me këtë mbyllet edhe neni. Pra, mbetet e paqartë se cilët persona fizik ose juridik mund ta bëjnë VNM-en. A duhet të jenë ekspertë të kësaj fushe, apo çfarëdo profili, si dhe - a duhet të ketë ndonjë dëshmi -licencë se janë të aftë ta bëjnë këtë punë? Nëse nuk precizohen këto këtu,

në ligj vetë Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor do të ketë probleme t'i vlerësojë raportet e përgatitur nga joprofesionalistët.

Edhe pse janë bërë përpjekje të sanohet kjo me nenin 18, përsëri mbetet shqetësim se mund të favorizohet një ambient korruptimi. Megjithatë si qasje shumë pozitive në këtë projektligj, duhet të thuhet, është përfshirja e publikut nëpërmjet debatit.

Neni 19 në procesin e konsultimit para marrjes së vendimit për dhënien ose refuzimin e pëlqimit mjedisor në bazë të kapitullit IV të projektligjit. Grupi ynë mendon se publiku gjatë debatit, jo vetëm të informohet dhe të konsultohet, por që vërejtjet e tij të merren në konsideratë nga zhvilluesi i projektit si dhe nga Ministria, para dhënies së pëlqimit mjedisor.

Grupi i AAK-së, duke konsideruar domosdoshmërinë e këtij ligji, e mbështet propozimin në parim dhe është i gatshëm që këtë ta bëjë gjatë procedimit. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të ORA-s, Gazmend Muhaxheri.

GAZMEND MUHAXHERI – Ju faleminderit, zoti kryetar!

Në fletën që i është bashkangjitur ligjit nga Ministria thuhet: - Ekziston Udhëzimi Administrativ që rregullon vlerësimin e ndikimit në mjedis, i cili është në zbatim, por kjo materie do të rregullohet me ligj edhe për faktin se duhet të harmonizohet me direktivat evropiane. Në vlerësimin e Zyrës së kryeministrit thuhet se edhe përmbajtja e projektligjit reflekton përmbajtjet kryesore, mirëpo shumë pjesë të rëndësishme nuk janë përfshirë.

Unë, thjesht, dyshoj se nëse ekspertët e Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, të cilët e kanë punuar këtë projektligj dhe nuk kanë mund të përshtatin me direktivat evropiane, si do të mund ta bëjë këtë Komisioni parlamentar?

Edhe një vërejtje, zoti ministër. Udhëzimi Administrativ i miratuar tre vjet më parë është shumë më i avancuar se projektligji, të cilin e keni sjellë ju sot për miratim në Kuvendin e Kosovës. Çka do të thotë kjo? Në listën që e keni bashkangjitur nuk ekzistojnë emrat e asnjërit nga ekspertët, të cilët kanë punuar në projektligj. Është praktikë që në projektligjet e tjera të punuara të jenë emrat e gjithë ekspertëve që kanë punuar në projektligj. Këtu, në këtë projektligj nuk ekzistojnë. Madje, Kuvendi i Kosovës nuk i ka.

Duke bërë krahasimin e Udhëzimit Administrativ dhe të projektligjit dhe kualitetit në rënie të këtij projektligji, duhet të keni parasysh se si iu funksionon Zyra ligjore. Në rregullimin që kërkohet të bëhet në këtë ligj, u hiqet e drejta komunave që të bëjnë vlerësimin e ndikimit të objekteve që do të ndërtohen në komunë dhe kjo përgjegjësi bartet në institucionin e Ministrisë, pa specifikuar se cilët persona do të marrin pjesë në vlerësimin e ndikimit në mjedis. D.m.th. është cekur vetëm se do ta bëjnë personat juridikë dhe fizikë, pa u caktuar se këta persona duhet të jenë të licencuar, që mund të bëjnë vlerësim të ndikimit në mjedis. Komuna duhet të jetë e interesuar më shumë se Ministria për atë se çfarë ndodhë në komunën e saj. Besoj se me ndryshimin që do të bëhet në projektligj, komunave duhet t'u jepen më shumë të drejta, sepse ato preken drejtpërdrejtë nga objektet, të cilat ndërtohen e vlerësimin e jep dikush në Ministrinë tuaj. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të Grupit 6+ Mahir Jagcilar.

MAHIR YAGCILAR – Ju faleminderit, zoti kryetar!

Ne si grup parlamentar 6+ e përkrahim në parim, por , gjithashtu ,dëshirojmë disa shpjegime, ose arsyetime rreth deklaratës. Në deklaratë thuhet se disa pjesë shumë të rëndësishme nuk janë e përfshirë në ligj dhe janë në kundërshtim me ... Unionin Evropian. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të LDD-së, Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI – Ju faleminderit!

I nderuari kryetar,

I nderuari ministër,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i LDD-së ka vlerësuar Propozimligjin dhe ka konstatuar se janë bërë ndryshime pozitive, të cilat kanë bërë të mundshme që në parim ta përkrahim. Megjithatë, që nga emërtimi që është i përgjithshëm e deri te disa josaktësi dhe pajtueshmëri ligjore mes dispozitave, nuk janë të definuar qartë ndikimet negative në mjedise të cilat në realitet janë të shumta në numër dhe të ndryshme në përmbajtje, megjithatë është qëndrimi ai që u theksua më lartë pa u përcaktuar qartë ndikimet negative të cilat mund të jenë të shumëllojshme dhe nuk mund të jenë të përjashtuara në procedurat e identifikimit, vlerësimit, administrimit, në raport me ndikimin negativ në rrethin që realizohen.

Pesë. Nuk është vetëm e nevojshme që një propozimligj të jetë në pajtueshmëri me rregullat e BE-së, por duhet shikuar që çdo propozimligj t'i adaptohet edhe rrethanave konkrete në Kosovë, me të vetmin qëllim që aplikueshmëria e tij të jetë shumë e arsyeshme dhe e bazuar. A mund të aplikohet në Kosovë për shkak të specifikave ekonomike dhe politike ekzistuese në raport me rregullat e përcaktuara nga OSBE-ja? Edhe të përkufizuarit, ka lëshime, si p.sh. projekti -nuk mund të nënkuptohet vetëm ekzekutimi i punëve të ndërtimit, por projekti është edhe pjesë ideore.

Neni 13.2 paarsyeshmërinë e aplikimit duhet dorëzuar Ministrisë në 6 kopje, ndërsa një kopje në formë elektronike në raport- çka vërtet vështirësojnë procedurën dhe nuk e kanë arsyeshmërinë e efektit.

Përveç përcaktimeve ligjore, mënyra më e drejtë dhe demokratike e mbrojtjes së ndikimit në mjedis është debati publik për çështjet me interes dhe pëlqimi i mjedisit, pa të cilin, mendojmë se nuk duhet ndërmarrë asnjë veprim i mbrojtjes së ambientit, ngase vetë mjedisi ,apo popullata janë ata që, ndoshta, jo më së miri, por shumëçka mund të definojmë në këtë drejtim. Në zonat ndërkufitare, ndikimi i mjedisit duhet rregulluar në raport bilateral ndërshtetëror mbi parimin e reciprocitetit dhe interesave e jo me ligje të njëanshme ,sepse ato në praktikën e gjertanishme ndërkombëtare kanë sjellë edhe konflikte të papajtueshmërisë ndërshtetërore. Masat ndëshkimore nuk janë edhe aq të arsyeshme. Me gjithë këto sugjerime që ne mendojmë se janë pozitive, Grupi Parlamentar i LDD-së edhe një herë konfirmon përkrahjen në parim me konstatimin se ne do t'ia paraqesim amendamentet tona Komisionit funksional. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të Grupit për Integrim, Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUSH – Pozdravljam sve prisutne. Nacrt zakona o proceni uticaja na životnu sredinu ima za funkciju direktnu zaštitu životne sredine te smatramo da treba da ide na usvajanje. U načelu podržavamo Nacrt zakona, slažemo se kao Grupa, ali slažemo

se isto i sa ostalim šefovima grupa koji su precizno analizirali zakon i želimo da se zakon dopuni sa preciznijim definisanjem nadležnosti ministarstva i opštinskih institucija. Znači, da se zakon prilagodi za teren Kosova i Evropske zajednice. Kao idejni projekat neka se vrati na doradu Pravnoj kancelariji. Hvala!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Naxhije Doçi.

NAXHIJE DOÇI – Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari zoti kryetar,

I nderuari zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis, i përgatitur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është shumë i mirëseardhur për ne në Kosovë, sepse krijon kushte legislative për kontrollim të veprimeve tona në shfrytëzim të mjedisit tonë hapësinor, në harmoni me nevojat tona.

Përmes këtij projektligji, do ta kemi parasysh me ligj ruajtjen dhe vlerësimin e ndikimit të mjedisit tonë si pasuri jo e çmuar dhe jo e vlerësuar sa duhet deri më tani. Me mjedisin është e lidhur tërë jeta e njeriut, prandaj bërja e ligjeve të mira për ta vlerësuar atë, është vetë bërja e jetës së mirë për vetveten. Ky projektligj është i mirë se krijon kushte për kriteret pozitive në dobi të parandalimit dhe të zvogëlimit të ndikimeve negative në mjedisin tonë gjatë vlerësimit të projekteve të propozuara nga aplikuesit.

Është e ditur se Kosova ka nevojë të madhe për zhvillim ekonomik sipas trendëve të kohës, sepse nuk është e zhvilluar, por ka nevojë të madhe edhe që zhvillimet e bëra t'i plotësojnë domosdoshmërisht kushtet e planit hapësinor. Konkretisht që t'i plotësojnë kushtet e rregullimit të jetës më të mirë dhe më të sigurt për ne dhe në aspektin e ruajtjes së shëndetit të popullatës së saj, si dhe në ruajtjen e botës bimore dhe shtazore në te.

Dihet se Kosova është ndër vendet më të dendura me banorë në një metër katror edhe se në te janë bërë ndërtimet e shumta pa kriteret - vend e pa vend të qëlluar ku, ndër të tjera, ndikim negativ bëjnë edhe ujërat e zeza që nuk kanë kanalizime të duhura, në fshatra jo se jo, por edhe nëpër shumë qytete të Kosovës. Krahas kësaj edhe rritja shumë e madhe dhe e shpejtë të numrit të veturave, të autobusëve dhe të trenave, dhe si pjesë më e madhe e tyre automjetet e vjetruara që ndikojnë në mjedis duke e ndotur ajrin dhe duke e rrezikuar në mënyrë të pakrahasuar shëndetin e banorëve të Kosovës.

Është e kuptueshme se qëllimi i këtij projektligji është parandalimi ose zvogëlimi i ndikimeve negative në mjedis të projekteve të propozuara nga konkurruesit dhe se nevoja për të është rregullimi i procedurave për sigurimin e informatave gjithëpërfshirëse mjedisore dhe kjo është e mirë dhe më se e duhur për t'u zbatuar. Megjithatë projektet e propozuara duhet që të parashohin gjithsesi edhe si të eksploatohen mineralet dhe si të mos ndikojë dëmshëm ky eksploatim në mjedis dhe në shëndetin e njeriut. Këto të dhëna është dashur të cekën në mënyrë më të qartë dhe që të konkretizohet si duhet dhe mirë ky qartësim, mendoj se duhet shtuar edhe një nen, pas nenit të dytë. Pra, të shtohet neni 3 dhe pastaj të vazhdohet me radhë.

Edhe pse në nenin 23 është e cekur se parashtruesi i kërkesës për projektin përkatës është i obliguar që t'i realizojë masat mbrojtëse të parapara në projekt, si dhe është i obliguar që t'i sigurojë edhe kushtet e caktuara sipas vendimit për pëlqimin hapësinor të

paraparë në raportin e vlerësimit të ndikimit hapësinor, duhet pasur edhe kritere të tjera shitesë, të precizuara mirë, që parashohin ruajtjen dhe sigurinë e mjedisit dhe të jetës së njerëzve e në veçanti për ruajtjen nga sëmundjet virusale që mund të shkaktohen.

Mendoj se krijimi i mjedisit të dëmshëm nga shfrytëzimi i xeheve minerale, qymyrit e tjera - është dhënë në një mënyrë të përgjithshme e nuk është dhënë me shembuj konkret. P.sh. është dashur të theksohet se kërkohen projekte të caktuara profesionale se si për të vepruar që të mos ndotet apo helmohet mjedisi hapësinor për rastet konkrete si në: Trepçë, Zveçan, Artanë, Obiliq-Kastriot, ose nëpër vendet e naftës që pritet të eksplorojnë si edhe nëpër fabrika të reja që priten të ndërtohen në Kosovë.

Projekti duhet të përmbajë edhe të dhëna gjatë procesit të prodhimit. Mbi bazën e kësaj propozoj që duhet paraparë edhe një nen dhe dy nene të veçanta për ruajtjen e mjedisit ekologjik në dy gjigantët tanë ekonomik, një për termocentralet në Kastriot dhe një për në Trepçën, përkatësisht Mitrovicën dhe atë tek vendimi për pëlqimin hapësinor në faqen 18 të projektligjit.

Pra, për termocentralet e Kastriotit të shtohet pas nenit 19 neni 20, ndërsa për Trepçën neni 21 e mandej të vijojë me radhë neni 22 siç është në projektligj.

Neni 20, i shtuar për termocentralet në Kastriot, si qendër me rëndësi për ekonominë tonë, është i domosdoshëm, në të cilën duhet të sqarohet mirë dhe në mënyrë rigoroze vlerësimi i ndikimit në mjedis, sepse ndotja e ambientit prej tyre rrezikon, pos banorët e fshatrave përreth edhe banorët e kryeqytetit të Kosovës, Prishtinës.

Termocentralet tona, që të mos e infektojnë dhe helmojnë ambientin me kemikalie dhe me gazra vdekjeprurëse, duhet të punojnë ngjashëm si veprojnë termocentralet e tilla të qymyrit nëpër vende demokratike perëndimore.

Shtimi i nenit 21 për Trepçën dhe Zveçanin është, po ashtu ,shumë i nevojshëm se duhet paraparë besim të posaçëm të ndikimit të mjedisit atje, ngase dihet që para një kohe në Mitrovicë dhe rrethinë ngordhnin me të madhe shpezët dhe shtazët nga kimikaliët e xeheve të Trepçës. Mendoj se ka pasur ndikime edhe në vdekjen e njerëzve. Pra përgjegjësimin e ruajtjes së ndikimit në mjedis nga ndotja prej xeherores apo shkrites së Stan-Tërgut mendoj se edhe këtu duhet marrë masa ngjashëm si veprohet me xeheroret e tilla minerale të ngjashme nëpër vendet perëndimore demokratike.

Ky projektligj ka 6 krerë dhe 36 nene sipas versionit të fundit dhe është në përputhshmëri me rregulloret evropiane të fushës së njëjtë dhe kjo është mirë dhe inkurajuese për ne, për një zbatueshmëri të suksesshme të realitetit tonë në këtë kohë të tranzicionit. Është një projektligj i punuar mirë si edhe është i mirë sepse ligji është, sipas versionit të fundit të përpunuar, edhe në përputhje me versionet e Bashkësisë Evropiane.

Është një Projektligj i punuar mirë edhe konceptualisht edhe gjuhësisht dhe është i kuptueshëm edhe pse nuk dihet se prej cilit vend është marrë si model si dhe nuk dihet edhe grupi punues që e ka përpiluar apo modifikuar si të tillë. Projektligji ka edhe të hyrat e veta që arrihen nga pagesat e tarifave dhe të kundërvajtjeve të personave fizik dhe juridikë që veprojnë në kundërshtim me dispozitat e parapara dhe që mendoj se janë të larta për kushtet tona në Kosovë. Propozoj që shuma ndëshkuese të jetë pak më e zvogëluar dhe mendoj se të jetë diku 2000 deri në 8000 në krahas me atë 3000 gjer në 10 mijë euro.

Në fund theksoj se Projektligjin e përkrahim në parim me shpresë të një finalizimi të suksesshëm në Komisionin Funkcional në plotësim të nevojave dhe të kërkesave të banorëve të Kosovës. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Nimon Alimusaj.

NIMON ALIMUSAJ – Ju faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar ministra dhe kolegë,

Nuk e kisha ndër mend të paraqitem, duke pritur se ata që u paraqitën në emër të grupeve parlamentare duhet të sqarojnë së paku titullin e këtij ligji, qartësinë dhe saktësinë në elementet kryesore të stilit ligjor. Unë në këtë titull të këtij ligji po e shoh një pasaktësi të plotë dhe një paqartësi të plotë. Projektligji është titulluar: -Vlerësimi i ndikimit në mjedis. Vlerësimi i cilave ndikime? Mund të ketë ndikime pozitive dhe negative.

Neni 1 e ka përcaktuar de fakto për cilat ndikime është fjala dhe atje thotë në nenin 1 se ligji ka synim zvogëlimin e ndikimeve negative. Edhe te përkufizimi i nenit 2 ku është përkufizuar termi vlerësimi i ndikimit në mjedis, nuk ka saktësi. Unë kujtoj se ky ligj duhet ta ketë këtë titull që të jetë i saktë, të jetë i qartë, sepse titulli jep në mënyrë më koncize përmbajtjen e ligjit dhe do të duhej të ishte - Projektligji për vlerësimin e ndikimeve negative në mjedis, ose të dobësive negative për vlerësimin e dobësive në mjedis, përndryshe kështu si është, nëse kalon në parim e pastaj nuk mund t'i ndryshohet titulli, nuk besoj se titulli ka dalë i qartë.

Prandaj, edhe një herë theksoj duhet të ishte- Projektligji për vlerësimin e ndikimeve negative, ose të ndikimeve të dëmshme ose të ndikimeve njerëzore në mjedis, përndryshe kështu si është - është krejt i paqartë. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, profesor! Fjalën e ka deputetja Sala Berisha- Shala. Le të përgatitet Nekibe Kelmendi.

SALA BERISHA - SHALA – Ju faleminderit, zoti Kryetar! Përsëritet, juve kolegë deputetë dhe anëtarë të Qeverisë.

Projektligjet që rregullojnë mjedisin janë jo vetëm të mirëseardhura, por dihet që janë obligative për futjen e Kosovës në BE.

Unë nuk do të zgjatem shumë, sepse disa prej vërejtjeve i cekën edhe kolegët e mi, por është shqetësuese vazhdimisht që në projektligje mungon edhe grupi punues, për të parë se çfarë ekspertësh kanë punuar në këtë drejtim.

Propozuesi i Projektligjit që në fillim në letrën shpjeguese i cek një sërë direktivash që do të zbatohen dhe që do të rregullojnë këtë fushë- thotë me rastin e nxjerrjes së akteve nënligjore. Mirëpo, në deklaraten e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së e shohim që ky projektligj nuk është në përputhje me aqua communitare. Për mua është dilemë e madhe, është në përputhje apo nuk është në përputhje, sepse deklarata është e lëshuar diku në mars të vitit 2007, ndërsa përmirësimi i këtij projektligji na vjen tash në gusht të këtij viti. Kisha dashur një përgjigje nga ministri se e përcolla me vëmendje se

gjatë ekspozesë së tij nuk e përmendi këtë defekt që është këtu në dokumentacionin dhe në projektligjin që na ofrohet.

Përveç tjerash, është një vërejtje që ndoshta do të merret si ma shumë si e dorës së dytë. Për mua është e papranueshme që në kohën e digjitalizimit të kërkohej 6 kopje të dokumentacionit, apo të aplikuesit që duhet të bëjë vlerësimin në mjedis. Kjo mendoj që ndoshta gjatë amendamentimit komisioni përkatës do t'i ketë parasysh këto dhe t'i ikim disa procedurave burokratike që e stërngarkojnë edhe aplikuesin. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi. Le të përgatitet deputeti Rifat Krasniq.

NEKIBE KELMENDI – Ju faleminderit, zoti kryetar!

Edhe unë më tepër dua të përqendrohem në titull e projektligjit. Me të vërtetë titulli i projektligjit nuk është i qartë dhe do të duhej të qartësohej, sipas mendimit tim titulli i ligjit do të duhej të ishte parandalimi i ndikimeve negative në mjedis, ose i faktorëve që ndikojnë në mjedisin ose disi, sepse kështu shumë është i paqartë vlerësimi i ndikimeve në mjedis, pothuajse është një projekt afatshkurtër dhe bën një vlerësim edhe hajt, kështu që le të mendojë sponsori mirë dhe le të përshtatet me nenin 1.1. titulli i ligjit dhe të miratohet si i tillë në lexim të parë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Rifat Krasniq.

RIFAT KRASNIQ – Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,
të nderuar deputetë,

Pasi që Ministria e Mjedisit e plotësoi kushtin formal, duke ia bashkëngjitur shtojcat këtij projektligji, tani sërish e kemi këtë projekt në leximin e parë. Ky projektligj do të garantojë sigurinë e projekteve të propozuara nga aplikuesi, ose zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis. Subjektit, i cili pretendon ta furnizojë me pëlqimin mjedisor, në bazë të këtij ligji, Ministria ia lëshon vendimin, pasi që siguron të gjitha informatat relevante për mjedisin.

Edhe pse kjo materie rregullohet me udhëzim administrativ, tani e tutje do të kemi ligjin i cili do të garantojë faktin e harmonizimit me direktivat evropiane, që është shumë me rëndësi për çështje mjedisore.

Dispozitat e këtij projektligji, sidomos sa i përket procedurës së paraparë të vlerësimeve të ndikimeve mjedisore, do të rishikohen nga ana e Komisionit përmes ekspertëve përkatës, si është për shembull rasti i debateve publike të nenit 19, ku duhet të saktësohen palët e interesuara për këtë debat -në ë pikën 5. Prandaj, unë nuk shoh ndonjë pengesë për miratimin në parim të këtij projektligji dhe ftoj Kuvendin për miratim. Ju faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Pasi që nuk ka diskutues të tjerë, lus... Po, urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI ARDIAN GJINI – Ju faleminderit, edhe një herë!

Të nderuar deputetë të Kuvendi i Kosovës,

Vetëm shkurt, dy - tri sqarime. Mirëpo, paraprkasht dua t'ju falënderoj për gjithë punën që e keni bërë dhe për mbështetjen që ia dhatë deri më tash ligjit. Çështja e emrit të ligjit është çështje ndërkombëtare, do të thotë terminologji ndërkombëtare, e cila është

përkthyer në të gjitha gjuhët e botës, fjalë për fjalë quhet kështu. Vlerësimi i ndikimit në mjedis. P.sh në anglisht është *evaluation of influence in environment*. Nuk përmendet gabim ose jo gabim, i keq ose i mirë, për shkak se është çështje shumë teknike - çështje profesionale, është përkthim profesional dhe në të gjitha gjuhët e botës përdoret njëjtë. Te numri i kopjeve ishte njëra prej vërejtjeve të tjera. Numri i kopjeve përcaktohet në bazë të institucioneve që do t'i shfrytëzojnë ato kopje si hord copy. Dy arsye janë pse kërkojmë shumë kopje. E para është për t'i ulur shpenzimet e Ministrisë për shkak se ato projekte janë shumë të mëdha - voluminoze, sidomos kur kemi të bëjmë me fabrika të mëdha. Ne kërkojmë që kopjet - materialin në të cilin do të punohet, ta sigurojnë vetë ata që i paraqesin, do të thotë që të mos ketë ngatërresa mes fotokopjimit ose humbjes së faqeve në Ministri dhe, po ashtu, kërkohet një kopje elektronike për punë dytësore.

Edhe te pajtueshmëria në aqua communitare, është përmendur disa herë këtu. Është e vërtetë që e kemi shumë vështirë që ta kemi qind për qind të përshtatur në aqua communitare ligjin sot për sot në Kosovë. Mirëpo, aktet nënligjore të cilat do ta plotësojnë këtë ligj në të ardhmen, ia mundësojnë Ministrisë, në disa raste Qeverisë, në disa raste të tjera edhe Kuvendit, që vazhdimisht ta përmirësojnë atë gjendje. Mendoj se e keni përmendur disa herë në Kuvend këtu, e keni përmendur edhe ju që është e pamundshme që qind për qind çdo element ligjor sot në Kosovë të jetë në përputhshmëri të plotë me aqua communitare, për shkak se do të duhet t'i mbyllim shumë kapacitete, do të duhet të kalojmë në diçka tjetër. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA– Ju faleminderit! Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, duke përfshirë vërejtjet që i dhanë profesor Nimon Alimusaj dhe Nekibe Kelmendi.

Votojmë tash:

Me 61 vota “për” dhe 6 “kundër” miratohet Projektligji, në parim. Këtu llogariten edhe dy vota me dorë.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2006.

Zyra e Rregullatorit për Energji, në pajtim me nenin 10 të Ligjit për Rregullatorin e energjisë, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin vjetor të punës për vitin 2006. Raporti është shqyrtuar nga Komisioni parlamentar për Ekonomi, Tregti, Energjetikë dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, të cilit Kuvendit ia kanë paraqitur rekomandimet e veta. Ftoj kryetarin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Energjetikë, nëse dëshiron ta marrë fjalën, zotin Ibush Jonuzi. Deputeti Ibush Jonuzi e ka fjalën.

IBUSH JONUZI – Ju faleminderit, zotëri i nderuar, Kryetar i Kuvendit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ibush, vetëm një moment. Urdhëro, Gani!

GANI KOCI – Me gjithë respektin për komisionin që do ta japë fjalën e vet për këtë raport, por do të ishte mirë që gjatë shqyrtimit të këtij raporti të ishte dikush këtu nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike, por gjithsesi të jetë edhe ministri prezent. Ne

mund ta diskutojmë, mund ta analizojmë, mund ta kritikojmë, por nëse nuk janë aktorët kryesorë këtu, atëherë kjo i bie sikur po flasim me vetveten tonë. Nuk është mirë që Kuvendi të flasë me vetveten, por të flasë me subjektet dhe t'i ketë parasysh dhe para vetes ato.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Zoti Ibush, urdhëroni, si kryetar i Komisionit. Urdhëroni, Ibush Jonuzi e ka fjalën.

IBUSH JONUZI – Ju faleminderit i nderuari kryetar i Kuvendit,
Ministër prezent,
Të nderuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,

Në bazë të Ligjit për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, neni 10 i këtij ligji Bordin e Zyrës së Rregullator për Energji e obligon që pas çdo viti kalendarik t'i paraqet raport me shkrim për punën e vetë Kuvendit të Kosovës. Andaj, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji iu ka përgjigj nenit 10 dhe Kuvendit të Kosovës i ka paraqitur raport për punën e vet njëvjeçare edhe pse me vonesë, por në punën e vet përveç punës njëvjeçare Bordi ka paraqitur edhe punën për tre muaj të këtij viti.

Komisioni funksional ka marrë raportin në fjalë dhe e ka paraqitur para komisionit funksional. Sipas ligjit për rregullatorin e energjisë nr. 2004/9 neni 10, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji është i obliguar t'i paraqesë Kuvendit të Kosovës raportin njëvjeçar për punën e vet.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me kujdes këtë raport dhe shpreh opinionin e vet pozitiv për nivelin e hartimit të këtij raporti i cili u punua nga bordi i përfaqësuar nga vendorët por dihet se në fillim të këtij viti kompetencat ku janë kaluar nga ndërkombëtarët, pra në fillim të këtij viti bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë udhëhiqet dhe është komplet nga vendorët. Ky raport u dorëzua me vonesë, por ne kuptojmë arsyen e saj, është fjala për mungesën e stafit punonjës të zyrës për rregullator për energji dhe një anëtar i bordit të Zyrës të Rregullatorit të Energjisë mirëpo, edhe pse raporti kërkohet të jetë njëvjeçar bordi ka raportuar edhe për tremujorin e parë të këtij viti gjë që e siguron edhe e arsyeton vonesën e vet.

Përgjithësisht, raporti është përmbajtjesor, gjithëpërfshirës, i strukturuar mirë dhe janë referuar saktë detyrat dhe obligimet që dalin nga ligji, prandaj nuk dua që ta interpretoj në tërësi, por po ndalem në disa çështje që mendoj se e kanë rëndësinë e veçantë, flasin për të arriturat e paraqitura që janë dhënë nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji.

1. Krijimi i operatorit të pavarur të sistemit transmetues që është bërë në vitin 2006 është një e arritur shumë e madhe në këtë drejtim,
2. Dhënia e 25 licencave për ndërmarrje vendore dhe ndërkombëtare të energjisë, të cilat janë aktive në sektorin e energjisë elektrike dhe të ngrohjes qendrore, mund të them se është një çështje mjaft me interes për ne.
3. Rishikimi i çmimeve në sektorin e energjisë elektrike ka rezultuar me dizajnimin e tarifave të energjisë elektrike.
4. Hartimi i legjislacionit sekondar që në këtë drejtim është bërë për vitin 2006, planifikohet të punohet edhe më tutje për vitin 2007.

5. Shqyrtimi i ankesave të konsumatorëve që deri më tani kanë arritur 21.358 ankesa në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë dhe sipas asaj që bordi ka raportuar në komision, dita - ditës ka të interesuar që të paraqesin ankesat e veta. Bordi ka shqyrtuar 15.695 ankesa, që do të thotë se në përqindje i ka shqyrtuar diku rreth 75% të të gjitha ankesave, që nënkupton se është bërë zbatimi në përpikëri i nenit 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
6. Monitorimi i punës së KEK-ut është bërë mjaft edhe në vitin 2006.
7. Pasqyrimi i zhvillimit në sektorin e ngrohjes qendrore. Bordi ka evidentuar në raport edhe humbjet teknike të KEK-ut, të cilat janë shqetësuese për shoqërinë kosovare. Këto humbje kapin shumën përafro 50% të shpenzimeve të përgjithshme të energjisë elektrike. Paraqitja reale e gjendjes në fushën e energjetikës nxjerr në pah dobësi dhe thërret për vëmendjen e shtuar dhe rolin serioz që duhet ta kenë faktorët relevantë në këtë fushë: KEK-u, Ministria e Energjisë dhe Minierave, Zyra e Rregullatorit të Energjisë dhe të gjithë konsumatorët për ndryshimin e situatës në të mirë.

Ky raport, si i tillë, është mbështetur nga komisioni funksional dhe gjithashtu mbështetet edhe nga Grupi parlamentar i LDK –së. Duke përgëzuar Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për këtë raport, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së kërkoj plotësimin e stafit profesional të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe emërimin e anëtarit të ri të Bordit që mungon.

Grupi parlamentar i LDK-së inkurajon Zyrën e Rregullatorit të Energjisë për një punë edhe më efektive në të ardhmen. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Ftoj përfaqësuesin e PDK-së ta marrë fjalën. Urdhëroni, zoti Xhemajli.

BAJRUSH XHEMAJLI- Përsëritet zoti Kryetar,

Zonja ministre,

Kolegë deputetë dhe të gjithë të pranishëm,

Vërejtja që e dha zoti Koci në fillim, ishte me vend, por mendoj u kalua në heshtje. Kryesia e Kuvendit nuk e ka kryer punën si duhet kur e ka dhënë në rend të ditës dhe se në rend dite s’e ka vënë Komisioni, por Kryesia. Ne, edhe ne vetë Komisionin kemi kërkuar që ta vëmë në rend dite atëherë kur do ta kemi shqyrtuar këtë raport. Prandaj, kjo është një shkelje që nuk do të duhej të bëhej. Sidoqoftë dhe marrë në tërësi, ky është një raport në të cilin është arritur të pasqyrohet puna që ka bërë Zyra e Rregullatorit të energjisë. Këtij raporti do të duhej t’i përmbledhet së paku për një të tretën më shkurt, pasi nuk ka pasur nevojë të ngarkohet me detaje aq të shumta sa të përshkruan deri në atë masë veprimtaritë të ndryshme dhe rolin e mekanizmave të ndryshme, ngase deputetët do të duhej të kishin njohuri, së paku elementare, për këtë materie. Në anën tjetër, ka mungesë shpjegimi i disa fenomeneve, të cilat kanë ndodhur gjatë punës së Zyrës së Rregullatorit.

Padyshim se është e rëndësishme paraqitja e raporteve të punës së rregullatorëve para Kuvendit dhe me këtë rast rëndësia është aq më e madhe kur kihet parasysh se roli i këtij rregullatori është shumë i madh dhe, pa dyshim, është rregullatori më i rëndësishëm dhe më i ndjeshëm nga të gjithë rregullatorët e fushave të tjera.

Nga Raporti shihet se kjo Zyra ka kryer një volum të madh të punëve që ka në domenin e veprimtarisë së vetë, pavarësisht se ka një numër të reduktuar punëtorësh. Mirëpo, në

këtë volum të madh të punës, ka pasur edhe të meta të mëdha, disa prej të cilave, do t'i vë në dukje.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës mendon se, ajo çka do të duhej veçanërisht të kihet parasysh në punën e rregullatorit është pavarësia që duhet ta ketë ky rregullator dhe të mos influencohet nga mekanizma e institucione të tjera, siç është, para se gjithash, Ministria e Energjisë dhe e Minierave, Qeveria, pastaj kompanitë e ndryshme, e në veçanti KEK-u.

Shqetësimi ynë ka qenë i vazhdueshëm dhe dua ta shpreh edhe tani se Zyra e Rregullatorit të Energjisë nuk ka mund t'u përballojë ndikimeve të jashtme nga presionet e mëdha që i janë bërë, në veçanti nga Ministria e Energjetikës dhe Minierave dhe KEK-u. Se Zyra e Rregullatorit nuk ka arritur të mbajë pavarësinë që të duhej ta kishte, u pa më së miri me rastin e përpilimit të tarifave. Zyra e Rregullatorit nuk është dashur t'i nënshtrohet presionit të MEM-it dhe KEK-ut që sistemi të jetë njëtarifor, vetëm e vetëm për shkak të paaftësisë së tyre për të kryer detyrat që iu takojnë. Kjo nuk ka guxuar të ndodhë, sepse sistemi njëtarifor nuk dëmton rënd vetëm xhepin e konsumatorëve, por edhe sistemin e bartjes pasi askush nuk kujdeset të kursejë në kohën e ashtuquajtur të PIK-ut kur ngarkesa është ma e madhe. Në fakt, askush nuk përfiton, përveç përtacisë së MEM-it dhe KEK-ut, të cilët do të duhej të mundësonin leximin e orëve me sistem shumëtariforë. Siç duket tentimi i MEM-it që tani udhëheq edhe KEK-un për ta ndryshuar Ligjin për rregullatorin e energjisë e ka disiplinuar Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, deri në atë masë, sa të mos i kundërshtojë edhe atëherë ku shihet qartë se e kanë gabim.

Këtë më së miri e ilustron fakti që edhe pse Zyra e Rregullatorit në këtë raport konstaton se plani ABC është i dështuar, prapëseprapë vazhdon të përkrahë zbatimin e këtij plani, në vend se të propozojë për ta ndaluar urgjentisht, meqë dihet se përpos që nuk ndihmon në inkasim, shkelen të drejtave dhe liritë e njeriut, ashtu siç shkelin edhe memorandumin e mirëkuptimit në mes dy ministrive - MEM-it dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme në lidhje me kushtëzimin që u bëhet qytetarëve që të mos mund t'i regjistrojnë veturat pa paguar rrymën, e cila çështje në këtë raport nuk përmendet fare.

Se Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka humbur pavarësinë, shihet edhe në faktin se për padrejtësitë që janë bërë nga Qeveria e vetë Rregullatorit me propozimin për ndërrimin e ligjit e tjera, pothuaj se nuk flitet fare në këtë raport apo edhe kur flet këtë e bën me një zë të mekur, pavarësisht se dikur në Komisionin parlamentar funksional flitet me zë të fortë, ashtu siç u takonte përfaqësuesve të kësaj zyre.

Me vendimin ekzekutiv 2006/6 i datës 17 mars 2006 PSPS-ës u janë marrë kompetenca të shumta Zyrës me ç'rast është shfuqizuar kapitulli i VIII i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Por, si duket futja e përfaqësuesit të Zyrës së Rregullatorit në Komitetin Tenderues për termocentralin Kosova C ka mjaftuar jo vetëm për t'i ulur gjakrat, por edhe për t'u shndërruar në altoparant të Qeverisë në lidhje me termocentralin Kosova C që po projektohet për t'u ndërtuar. Ndryshe, nuk ka si të kuptohet e gjithë ajo hapësirë që është dhënë në raport ndërtimit të këtyre kapaciteteve prodhuese në mënyrën më afirmative. Se Zyra e Rregullatorit në raport mundohet të fshehë paaftësinë e Qeverisë dhe të KEK-ut, shihet edhe në faktin se në formën tabelore të dhënave edhe pse nuk ka ndonjë përparim në faturim, inkasim e tjera, prapëseprapë me fjalë vazhdimisht thuhet sikur punët kanë marrë të mbarën. Madje, në faqen 41 të raportit kur flitet për shkallën e arkëtimit dhe ku bëhet krahasimi me regjionin, jepet shifra 65% inkasimi i shumës së

faturuar, që në fakt nuk tregon asgjë kur dihet fakti se gjysma e rrymës nuk faturohet. Krahasoni me regjionin do të ishte real sikur të tregohej edhe shkalla e faturimit në shtetet e tjera.

Pika më e dobët e punës së Zyrës është mbrojtja e konsumatorit si një nga detyrat kryesore që ka.

Ajo çka thuhet në kapitullin e pestë të raportit kryesisht ka të bëjë me ankesë të konsumatorëve si dhe shqyrtimin e tyre, por i ikët me mjeshtëri diskriminimit që Zyra ua bënë konsumatorëve. Në njërin anë mbështet plani ABC dhe vetë ndihmon diskriminimin e konsumatorëve që paguajnë rregullisht, kurse në anën tjetër në raport thuhet, dhe po citoj: “KEK-u ka dështuar në implementimin e kushteve të dhëna përmes vendimit të Zyrës dhe konsumatorëve të rregullt të grupeve B dhe C kanë arsye që të jenë të pakënaqur”. Dhe, unë them se, përveç që kanë të drejtë të jenë të pakënaqur, ata kanë të drejtë edhe ta padisin KEK-un dhe duhej ta fitonin gjyqin në cilindo shtet demokratik që do të ishin, pasi që paguajnë me rregull rrymën, e rrymë nuk kanë. Ajo shkon tek ata që nuk paguajnë e që janë në grupin A dhe sigurisht që do të ankoreshin konsumatorët, por KEK-u, Zyra, dhe Qeveria aq shumë e kanë lodhur konsumatorin me maltretime që i bënë në rast ankese, sa që e kanë bërë të pashpresë se mund t’ia dalë, bëhen edhe atëherë kur ka të drejtë. Për këtë fletë fakti se nga 21.358 ankesa 5.663 nga ato as që janë marrë në shqyrtim dhe kjo dekurajon konsumatorët e tjerë për t’u ankuar.

Nga raporti shihet se Zyra e Rregullatorit ka bërë një punë të madhe në licencimin e shumë kompanive. Ajo që do të duhej pasur me kujdes në këtë drejtim është çështja e konfliktit të interesave për faktin se njerëzit të ndryshëm punojnë njëkohësisht edhe në kompani të caktuara ku prodhohet rryma edhe si konsulentë në firma tregtare ku blihet ajo, gjë që të lë të kuptosh që është një punë e dyshimtë.

Në fund dua të theksoj se përkundër faktit që në sektorin e energjisë është bërë shtuarja dhe korporatizimi i operatorit të pavarur të sistemit të transmisionit edhe tregut KOST, nuk mund të funksionojë si model. Janë të kuptueshme pengesat që vijnë nga Serbia, duke mos njohur fare KOST-in si të tillë, por është për t’u brengosur se nuk njihet as nga Operatori i Sistemit të transmisionit për Evropën Juglindore, pastaj as nga tregtimi ndërkufitar dhe nga CSA-ja, përkundër faktit se Rregullatori i Pavarur i Energjisë njihet në Evropën Juglindore, me drejta të barabarta. Dëmi është i madh, sepse tregtimi i rrymës për të furnizuar ne, bëhet nga një palë e tretë, pra indirekt me ç’rast konsumatori në Kosovë paguhet më shtrenjtë.

Sidoqoftë, ky është një problem politik, të cilin do të duhej ta kishte zgjidhur UNMIK-u. Në fakt arsyet e mosnjohjes të këtij operatori nga të tjerët nuk janë dhënë në raport dhe kjo padyshim është një e metë e këtij raporti.

Duke i pasur parasysh të gjitha këto që i thash, Grupi Parlamentar i PDK-së miraton këtë raport pune, duke kërkuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë që: të ruajë pavarësinë e vet, të marrë qëndrim të drejtë në lidhje me sistemin tarifor, ashtu që të jetë dy tariforë, të mos mbështesë planin tejet të dëmshëm ABC, të mos mbështesë memorandumin e mirëkuptimit në mes dy ministrive për kushtëzimin e regjistrimit të veturave, të bëjë më shumë në parandalimin e konfliktit të interesit të personave të punësuar në kundërshtim me ligjin. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të AAK-së Mazllo Kumnova.

MAZLLOM KUMNOVA – Zoti kryetar, grupi ynë parlamentar ka shqyrtuar me kujdes raportin vjetor për vitin dhjetor 2006 të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe me këtë rast ka konstatuar.

E para. - Raporti është mjaft i detajuar dhe profesional dhe ky agjencion i pavarur ka bërë përpjekje që të evidentojë të gjithë veprimtarinë e saj gjatë vitit 2006, të realizuar në bazë të ligjit ,duke u përqendruar në rregullimin dhe mbikëqyrjen e funksionit operues kyç të ndërmarrjeve në sektorit e energjisë dhe, më konkretisht, të energjisë elektrike, të gazit dhe të ngrohjeve qendrore.

Padyshim, përpjekjet që ka bërë ky agjencion që në Kosovë të krijohen kushtet e favorshme për një treg të hapur e konkurrues të energjisë, sidomos kur është çështja e investitorëve të huaj , duke zbatuar direktivat e Bashkësisë Evropiane për Energji, si dhe detyrimet që dalin nga marrëveshja për komunitetin e energjisë në Evropën Juglindore mes nënshkruesit të kësaj marrëveshje që nga viti i kaluar, me sa di unë - është edhe Kosova.

Sipas këtij raporti Zyra e Rregullatorit për Energji gjatë vitit të kaluar ka lëshuar 25 licenca për ndërmarrjet vendore dhe ndërkombëtare, jo vetëm për sektorin e energjisë elektrike, por edhe për ngrohjen qendrore në Kosovë,si dhe monitorimin e tyre. Në këtë kontekst duhet vlerësuar ndërhyrjet e para të rishikimit të çmimeve në sektorin e energjisë dhe ngrohjes, përpjekjet që po bëhet në drejtim të zhvillimit dhe miratimit të instrumenteve dhe kodeve për tregun e energjisë.

Duke jetuar në situatën e vështirësuar energjetike në Kosovë dhe perspektivën e sanimit të gjendjes dhe mundësitë e projekteve që Kosova të jetë edhe eksportuese e energjisë për një periudhë kohore të ardhshme ,kjo zyre është kyçur drejtpërdrejt në këtë strategji të energjisë dhe ka dhënë kontributin e saj.

Ky Kuvend, përveç se është përgjegjës për të vlerësuar veprimtarinë e kësaj Zyre, në vitin e kaluar përmes Komisionit për Buxhet e Financa ka bërë përpjekje t'i rreshtojë këto agjencione dhe, me sa duket, është vendosur një rregull sidomos të çështja financiare. Mirëpo, në këtë drejtim ka pasur ndërhyrje të Qeverisë dhe në këtë mënyrë ka rrezikuar edhe pavarësinë e tyre. Kjo politikë, e ka goditur më së shumti këtë zyre dhe disa agjencione të tjera. Kështu, nga Zyra e Rregullatorit për Energji janë larguar në fund të vitit të kaluar, e sidomos në fillim të këtij viti, mjaft ekspertë duke rrezikuar edhe funksionimin e këtij agjencioni.. Kur kësaj i shtohet edhe ajo se kjo zyre nga fillimi i këtij viti, trajtohet nga vendorët, atëherë pasojat janë evidente.

Përpjekjet e këtij Kuvendi janë të krijuar kushte të favorshme të funksionimit të institucioneve të pavarura, sepse janë të rëndësishme për një shoqëri demokratike. Mendojmë se prioritet janë rishikimi i politikës financuese të këtyre agjencioneve. Padyshim, kjo duhet mbështetur me plotësimin dhe përmirësimin e anës ligjore, duke klasifikuar, sidomos strukturën e ekspertëve në nivelin e punëtorëve të nevojshëm, që është e tolerueshme dhe ka kohë që të zbatohet.

Edhe një herë, zoti kryetar, ne si Grup parlamentar mbështesim raportin e Zyrës së Rregullatorit për Energji, kuptohet Raportin e vitit 2006. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të ORA-s e ka fjalën Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA – Ju faleminderit zoti kryetar.

Sot jemi duke e shqyrtuar Raportin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe duhet të përshëndes këtë praktikë për të cilën edhe është e thirrur që të japë raport dhe do të kisha sugjeruar që edhe komisionet tona dhe institucionet e tjera të japin raport, në mënyrë që Kuvendi të shqyrtojë dhe të japë rekomandime për punën e tyre në mënyrë që ajo punë të jetë më e dobishme në të ardhmen.

Sa i përket sektorit të energjisë, e dimë që sektori i energjisë për Kosovë është një sektor i rëndësishëm së jashtëzakonshme sot, dhe i një rëndësie edhe më të madhe nesër për zhvillimin ekonomik të vendit.

Duke pasur parasysh këtë, atëherë shtrohet nevoja që edhe Rregullatori i Energjisë të jetë një rregullator, një zyre e rëndësishme së veçantë, një zyre profesionale e përgatitur në mënyrë bashkëkohore, e aftë për t'u përballuar me këtë lëmi të komplikuar.

Ne si grup parlamentar, apo si një grup kemi vizituar Zyrën e Rregullatorit dhe jemi njoftuar me problemet, me sfidat, me t'gjitha ato me të cilat përballlet kjo zyre. Dhe, duke pasur parasysh të gjitha këto, mendojmë që kjo lëmi – lëmi e energjetikës kërkon që edhe zyra të jetë, si thash edhe më parë, një zyre profesionale dhe zyre e cila do të jetë e pavarur në vendimet e veta, e pavarur nga ndikimet e jashtme, nga ndikimet e ministrisë, të Qeverisë, apo edhe nga ndikimet e tjera, në mënyrë që të jetë sa më dobiprurëse për qytetarin, për institucionet edhe për shtetin e Kosovës. Them këtë, se duke pasur parasysh që kohë më parë kemi pasur ngritje- zbritje të tarifave me të cilat, ndoshta pa të drejtë, kjo zyre ka qenë në ndikimin e fuqishëm të faktorëve të tjerë të cilët kanë ndikuar në vendimet e tyre. Prandaj, mendoj që gjatë këtij debati do të duhej që të sigurohet një pavarësi e plotë e kësaj zyre, në mënyrë që të jetë sa më profesionale.

Kur lexojmë këtë raport, mendojmë që është një raport mjaft detal, ndoshta diku më shumë e diku më pak, por mendojmë se është një raport i mirë dhe dëshirojmë që me raportime të tilla të vazhdohet dhe të ruhet pavarësia e kësaj zyreje. Ju faleminderit

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të Grupit 6+ Mahir Yagcilar

MAHIR YAGCILAR – Po faleminderit z. kryetar.

Edhe Grupi Parlamentar 6+ e përkrah Raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji, por vërejtja ekziston se raporti ishte pak i vonuar, por, gjithashtu, besojmë se në të ardhmen Zyra e Rregullatorit do të dorëzojë raporte edhe të rregullta edhe me kohë. Ju faleminderit.!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të Grupit për Integrim Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUSH – Pozdravljam prisutne, ujedno pozdravljam i izveštaj Kancelarije za regulatore. Ja sam slučajno i član Komisije za energetiku, gde smo detaljno obradili izveštaj i čuli ovu gospodu iz Kancelarije za regulatore za energiju, tako da smo izveštaj na istoj komisiji usvojili.

Međutim, danas ja u svoje ime, u ime Grupe za integraciju, više u svoje ime, dala bih do znanja da je danas veliki propust zašto se između nas ne nalazi jedan od ovlašćenih od same Kancelarije regulatora. To je nezavisna kancelarija i danas su oni dužni da ovaj Skupštini daju izveštaj lice u lice. Zašto smatram ovo? Zato što smo na komisiji, ja lično postavila neka pitanja kada je u pitanju proizvodnja, nabavka energije, kada su u pitanju gubitci, naplata. To su jako važni segmenti za kosovsko društvo. Danas znamo da se više nalazimo u mraku, nego da imamo energiju.

Ovako, ja sam radnica KEK-a i zahvaljujući ovom mom radu u KEK-u, smatram da poznajem, donekle poznajem situaciju KEK-a.

Na primer, ja ću da dam jedan običan podatak da je sa istim kapacitetima 99. godine proizvedeno, sve potrebe Kosova su bile pokrivene i 48% energije smo imali za prodaju. Danas imamo iste kapacitete, imamo isti ugalj, ista nalazišta, isto iskopavanje, a naša struja, proizvodnja je opala, drastično opala.

Ja sam slučajno gospodinu iz Regulatorne kancelarije rekla da se mi danas ne možemo nositi sa interkonekcijom struje. Šta to znači? Znači 20% mi treba da imamo povećanu proizvodnju energije da bi mogli da primamo i da dajemo kada nemamo dovoljno energije za Kosovo. Šta se danas dešava? Mi nemamo za potrebe Kosova, a to je jako žalosno, jer energija je jedan od najvažnijih segmenata za razvoj Kosova. Zašto? Niko neće od stranih investitora da dođe i da investira tamo gde nema stabilne energetske situacije.

Slučajno sam u izveštaju videla koje su sve obaveze Kancelarije na osnovu Zakona o regulatoru, odnosno videla sam koje su sve obaveze i gde treba da ima svoje segmente samostalnosti Kancelarija za regulatore. I, nadam se da nas sluša neko od predstavnika Kancelarije za regulatore. Znači, Kancelarija za regulatore po zakonu ima neograničenu mogućnost da posmatra rasčlanjivanje, znači iznošenje pravnog oblika organizacije, odlučivanje i obračune energetske preduzeća. Mi znamo da od energetske preduzeća, danas na Kosovu imamo samo KEK. Šta drugo ima? Da usvaja opšte uslove snabdevanja energijom, znači da usvaja opšte uslove snabdevanje energijom. Opet snabdevanje energije treba joj garantuje KEK.

Pod tri, da rešava sporove između potrošača i energetske preduzeća. Energetsko preduzeće je opet jedno, a potrošača ima - znate koliko, koji su nezadovoljni. Da revidira, usvaja i kontroliše saglasnost sa svim tehničkim pravilima, uključujući pravila trgovine i pravila pristupa. Zašto sam ovu tačku izdvojila. Evo, slučajno sam ovde videla u ovom izveštaju da u zadnje vreme – kaže da su 4 velika međunaroda konzorcijuma, 30. decembra 2006. godine, pokazala da zadovoljavaju 4 postavljena kriterijuma. Znači, naša kancelarija, naša Vlada, da kažemo ministar za energetiku, ušli su u saradnju sa 4 konzorcijuma, i to su: Nemačka, Paver agencija, zatim Nemačka i Američka Agencija MBV, zatim ČEZ - Češka agencija i Grčka i Italijanska agencija NL. Šta ovo znači? Slučajno sam na WEB stranici pročitala šta se danas dešava, nemojte da mi zamerite, u Srbiji. Isto sam našla ovu ČEZ organizaciju za snabdevanje i trgovinu energijom, strujom. Mi znamo da se danas nalaze mnoge agencije na tržištu sa kojima se trguje, struja je isto roba, i ova ČEZ agencija je sada najaktuelnija agencija gde se otvoreno kaže da su Vlada i ministri energetike u Srbiji znajući trpali i punili depove ove agencije da preprodaju njihovu struju. Da li se to isto dešava na Kosovu, gde ostajemo bez struje? Svaka čast da preprodajemo, da se nalazimo na ovom tržištu, ali kada zadovoljimo naše domaće potrebe. Mi mućimo narod sa podelom A,B,C, mućimo narod sa velikom i

visokom cenom koja je 48% veća u regionu od ostalih članica i veçito ostavljamo nerešena pitanja kad su potrošaçi i distribucija u pitanju.

Ova kancelarija nema nadležnost nad KEK-om. Ja ovde tvrdim i kažem da se danas KEK ponaša kao zakonodavac, a ne da sprovodi zakon.

Mi kao komisija smo ovaj zakon doneli, i kao poslanici njene nadležnosti moramo da uredimo i da tražimo da komisija u svom radu bude nezavisna kada je u pitanju KEK, koji se monopolski ponaša i sa cenom, i sa distribucijom, i sa prodajom i sa nabavkom, i sa isključenjima i to samo šteti Kosovo i kosovskoj privredi i kosovskom narodu, a korisno je za džepove pojedinaca. Ovo tvrdim, materijalno i moralno ovde pred svima kao radnica KEK-a.

Molim vas, iz ove Kancelarije za regulatore da se obavezno pozove predstavnik kancelarije, da bude prisutan ministar, da bude prisutno celo telo borda, a ovde neću da napominjem kada su u pitanju novi objekti, da razmatramo ovu situaciju. Ja imam predlog da ovu situaciju razmatramo mnogo, mnogo ozbiljnije. Hvala!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të LDD-së, Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI – Ju faleminderit kryetar. Edhe Grupi Parlamentar i LDD-së shqyrtoi raportin e Zyre së Rregullatorit të Energjisë dhe në bazë të asaj që është prezantuar aty, konstaton se, ndonëse, është përmbushur forma juridike, raportit i mungojnë disa elemente, të cilat në pika të shkurtra do t'i elaboroj.

E para, raporti është i vonuar dhe nuk është më aktual në shumëçka nga përmbajtja që ofron, ngase tanimë shumëçka ka ndryshuar nga viti 2006 dhe jemi në fund të vitit 2007. Nuk paraqet të gjitha të dhënat për gjendjen e energjisë në Kosovë dhe pasojat dhe si rezultat i kësaj këto të dhëna nuk janë në pajtueshmëri me aktualitetin në raport me raportin që paraqitet. Të dhënat për licencimin për energji nuk janë të specifikuara dhe si të tilla këto licenca paraqesin një joseriozitet në dhënien e tyre. Pastaj është mosshpjegimi i inkasimit në disa mjedise, pasojat dhe inkasimi në pjesët e tjera që shprehet pikërisht mbi bazat nacionale që nuk është paraqitur në raport dhe duhet të figuronte, sepse është realitet i kohës.

Në raport, po ashtu, masat për efikasitetin e punës dhe eliminimin e dobësive, nuk janë paraqitur.

Raporti nuk i sqaron mënyrën e tarifave dhe format e shfrytëzimit të rrymës si përditshmëri dhe mungesën e saj.

Në veçanti, ky raport nuk paraqet dhe nuk njeh qytetarët për faktin e pengesave me rastin e regjistrimit të automjeteve të pronarëve shqiptarë të pjesës veriore të Kosovës, për shkak të prezantimit të faturave të rrymës elektrike, kurse në të vërtetë ata nuk kanë ku t'i marrin ato, sepse nuk paguajnë edhe si shqiptarë e të tjerët dihet. Prandaj, të gjitha këto probleme do të duhej të paraqiteshin në raport, sepse ai është një dokument i një veprimtarie të një zyre, e cila në realitet është edhe pjesë e punës një Qeverie.

Megjithëkëto lëshime dhe sugjerime, Grupi i LDD-së e miraton këtë raport me shpresë se raportet e ardhshme do të jenë më përmbajtjesore dhe do t'i eliminojnë dobësitë që u paraqitën këtu nga të tjerët dhe unë. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Behxhet Brajshori e ka fjalën.

BEHXHET BRAJSHORI – Ju faleminderit zoti kryetar, të nderuar kolegë deputetë. Raporti i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë që sot e kemi para veti, mendoj se është mjaft përmbajtjesor, bile në të vërtetë këtu është pasqyruar tërë puna deri në detaje e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe ajo që mua më vjen mirë që ka diktuar vetë Zyra e Rregullatorit janë dy çështje: - e para ka të bëjë me importin e energjisë elektrike, përkatësisht me mesataren e tenderuar të çmimit të importit të energjisë elektrike që në raport thuhet se është 54 pikë e diçka dhe mesatarja e ponderuar e çmimit të eksportit të energjisë elektrike që është më e vogël se sa ajo e importit. Unë do të doja se këtu të bëjë një përpjekje për një përafrim të çmimit të importit dhe të eksportit, me qëllim të ruajtjes së mjetet buxhetore që do të realizoheshin nga shitja dhe blerja e energjisë elektrike. E para dhe e dyta, Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka konstatuar me drejtë se kemi humbje shumë të mëdha, sidomos kemi humbje jo teknike. Nuk po i përmendi ato të cilat janë, sepse vetë raporti thotë dhe këtu, po ashtu, kemi humbje të konsiderueshme financiare. Nëse arrijmë që t'i zvogëlojmë këto humbje që Zyra e Rregullatorit mund të ketë qasjen e vetë në KEK-un për të bërë këtë, atëherë, po ashtu, do të kemi një mundësi më të madhe për të ruajtur buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe të hyrat të sigurohen nga vetë afarizmi i KEK-ut.

Një çështje tjetër që unë dua ta potencoj është nevoja që të kemi një angazhim shumë edhe më të madh të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për mbrojtjen e konsumatorit. Ne kemi shumë herë ndërprerje të energjisë elektrike. Konsumatorët kanë dëme të caktuara dhe natyrisht furnizuesi me energji elektrike duhet të bëjë kompensimin e dëmeve. Nuk them Zyra e Rregullatorit, por KEK-u duhet ta bëjë këtë, kurse si monitorues Zyra e Rregullatorit të Energjisë duhet të gjejë fuqinë ligjore që ta detyrojë KEK-un për të bërë këtë çështje dhe natyrisht për ta mbrojtur konsumatorin. Apo, natyrisht për të respektuar kodin, do të thotë për mbrojtjen e konsumatorit bazuar në Ligjin për energjinë elektrike.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka bërë një punë të mirë dhe të madhe në nxjerrjen e legjislacionit dytësor që i mundëson, do të thotë, një monitorim shumë më të mirë të punës që e bënë KEK-u nëpërmjet atij legjislacioni që ata e vejnë në funksion. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Lus deputetët të jenë të gatshëm për votim.

Votojmë Raportin e punës së Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2006.

Votojmë tash. Kush është për?

Për.....47,
Kundër.... 8 .

Miratohet raporti i Rregullatorit të Energjisë për vitin 2006.

Ju faleminderit. Do të shkojmë në pushim të drekës, deri në orën 15, 30 minuta.

(Ndërhyrje nga vendi pa kyçur mikrofonin, nuk dëgjohet)

KRYETARI KOLË BERISHA: Pajtohem me atë, por vetëm këtë pikë të rendit të ditës, jo të tjerat.

SABRI HAMITI – Çka po doni? A po doni ta vazhdojmë? Vazhdo edhe një pikë.

KRYETARI KOLË BERISHA – A e vazhdojmë këtë pikë apo jo? Po. Atëherë, uluni! Pika e 7 të rendit të ditës.

**- Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për bartjen
mjetet buxhetore të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2007.**

Komisioni për Buxhet dhe Financa në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë ka shqyrtuar kërkesën e zyrës së Rregullatorit për Energji për bartjen e mjeteve buxhetore dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimin.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Naser Osmani ta marrë fjalën.

NASER OSMANI – Ju faleminderit zoti Kryetar,

Në emër të Komisionit kam bërë një kërkesë të bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike, neni 27.3, që të bëhet transferimi i mjeteve të zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike në vlerë prej 45 mijë €. Kjo është e bazuar në kërkesën që ka sjell drejtori i bordit të kësaj zyre që është drejtuar edhe Ministrit të Financave dhe që është dhënë në sqarim që një transfer të tillë duhet ta bëjë, pikërisht Kuvendi. Arsyeja është e vetme se gjatë hartimit të buxhetit të vitit 2007 nuk e kemi shqyrtuar me kujdes një çështje që ka rezultuar me ikjen e ekspertëve nga kjo zyre, që tani ka pasoja në punën e mirë të kësaj zyre që mori mirënjohje edhe lëvdata edhe nga raporti që sa po u aprovua. Prandaj, konsideroj që kjo duhet të aprovohet.

Këtu, dua të bëj një sqarim që ky vendim apo ky rekomandim i Komisionit është fuqizuar edhe në mbledhjen e fundit, më 23, që është mbajtur të enjten dhe konsideroj që ka marrë fuqinë e vet të mjaftueshme që sot të miratohet. Besoj që deputetët do të kenë konsideratë dhe mirëkuptim. Është çështja që ky institucion të jetë ashtu i pavarur si është kërkuar, që Qeveria të mos implikohet as në pjesën financiare që ka të bëjë me agjencitë e pavarura, veçanërisht në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë Elektrike, në ART-në dhe me Agjencinë Antikorrupsion. Kërkoj mirëkuptim dhe përkrahje nga gjithë deputetët. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Për fjalë është paraqitur deputeti Gani Koci.

GANI KOCI – Ju faleminderit zoti kryesues, të nderuar deputetë.

Më gjithë respektin për kryetarin e Komisionit dhe për vetë Komisionin për Buxhet të Kuvendit të Kosovës, unë dua të ndalem pak në procedurën se si është marrë ky vendim, që konsideroj se ka një shkelje edhe përkundër faktit se kërkesa është plotësisht e arsyeshme dhe plotësisht e drejtë. Kërkesa e Agjencisë, kërkesa e Zyrës së Rregullatorit për bartje të mjeteve. Në mbledhjen sipas këtij vendimi 31.07. në mbledhjen e fundit të mbajtur, është marrë ky vendim, Komisioni nuk ka pasur kuorum dhe nuk është marrë ky vendim. Ka pasur një qëndrim të përbashkët në parim që duhet të përkrahet kjo kërkesë e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike, por vendim nuk ka pasur. 23 korriku ka

qenë , në parim jemi pajtuar se duhet të përkrahet, por vendim nuk është marrë. Kjo është arsyeja edhe pse kërkesa është e drejtë. Është mirë që më në fund edhe Komisioni edhe vetë ministri kanë përkrahur bartjen e mjeteve financiare për funksionim më të mirë të kësaj zyre .Pra, kur është dashur dhe kur është folur rreth ndarjeve buxhetore për vitin 2006, pikërisht Grupi Parlamentar dhe Komisioni për Buxhet kanë kërkuar nga Komisioni dhe nga ministri që të respektohet Ligji i Zyrës të Rregullatorit të Energjisë Elektrike, i cili ligj, edhe në aspektin e shërbimeve që kryente, por edhe në aspektin financiar përcaktohet shumë qartë dhe shumë drejt. Më në fund, më vjen mirë që edhe vetë ministri edhe vetë Komisioni, sepse edhe shumica e anëtarëve të Komisionit e kanë kuptuar se duhet respektohet ligji.

Ligji për Rregullatorin e Energjisë Elektrike, në kuptimin e financave, nuk është respektuar pikërisht nga ky Komision dhe nga vetë ministri.

Se është kështu unë duhet të përmend vetëm Ligjin. Ka pas një këmbëngulje shumë të madhe në përcaktimin e pagave të anëtarëve të Bordit të Rregullatorit të Energjisë Elektrike dhe nuk është respektuar neni 8 i këtij ligji që përcakton saktë se cila është paga ose cila duhet të jetë shkalla ose niveli i pagës të kësaj zyre.

Shpresoj shumë që në projektimet buxhetore për vitin 2008, ministri nuk do ta bëjë të njëjtën gjë, nuk do ta thyej ligjin dhe shpresoj shumë që edhe Komisioni do të jetë në nivelin e detyrës së vet për të mbikëqyrë respektimin dhe zbatimin e këtij ligji.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike ka qenë në presion edhe në aspektin e ushtrimit të kompetencave të veta që i ka mbi bazë të këtij ligjit, por edhe në aspektin financiar. Edhe kur u shqyrtua më herët raporti, nuk u paraqita që të flas për vetë faktin që nuk ishte ministri këtu dhe s'ishte drejtuesi i kësaj zyre dhe të kërkoja prej tyre të thonë se cilat kanë qenë vështirësitë e kësaj zyre në ushtrimin dhe respektimin e funksioneve dhe përgjegjësi të veta që i ka pasur.

Edhe në aspektin e kompetencës së rregullimit të çështjeve, Qeveria dhe Ministria përkatëse kanë bërë një presion të jashtëzakonshëm që e ka zhveshur nga kompetencat me ndërhyrje të urdhëresave administrative, që i kanë konvnuar dikujt për qëllime të caktuara.

Po them, kërkoj nga kryesuesi i Komisionit, nëse jemi ne si anëtarë të Komisionit këtu të gjithë për një minutë të marrim vendimin e drejtë rreth këtyre ndarjeve, sepse vendimi ekzistues nuk është i plotfuqishëm për shkak të procedurave. Nëse dëshirojmë t'i themi procedurat, unë në parim jam që këto bartje të bëhen por duke i respektuar gjithmonë procedurat. Kërkoj respektim të procedurave edhe në këtë rast. Ju faleminderit!.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Fjalën e ka kërkuar Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI – Ju faleminderit zoti kryesues, kolegë deputetë!

Unë përkrah në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë propozimin për bartjen e këtyre mjeteve, por njëkohësisht edhe si anëtare e këtij Komisioni, ne kemi shqyrtuar edhe raportin e kësaj zyre, por edhe këtë kërkesë për bartjen e këtyre mjeteve buxhetore dhe pajtohemi për t'u bërë kjo bartje natyrisht duke i respektuar procedurat.

Njëkohësisht shfrytëzoj rastin që t'i bëj thirrje Kuvendit që të ketë kujdes në këtë drejtim, që vërtet, pagesa e këtyre bordeve, apo e këtyre ekspertëve të merret një vendim ose të respektohet ligji që të paguhet të gjithë, ndoshta kisha me thënë në një nivel, për arsye se ekspertët në çdo fushë janë ekspertë, dhe mos të na ndodh si ka ndodhur këtu që të ikin ekspertët nga kjo zyre e pastaj ne e dimë se çfarë problemesh kemi, qoftë në AER, qoftë në energjetikë e borde të tjera që i ka themeluar vetë ky Kuvendi. Edhe një herë po them, në emër të këtij grupi ne përkrahim bartjen e këtyre mjeteve, sepse ata kanë qenë shumë të fuqishëm dhe e kanë arsyetuar këtë bartje të këtyre mjeteve. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit! Fjalën e kërkon deputeti Mazllom Kumnova.

MAZLLOM KUMNOVA – Zoti kryesues, në kuadër të asaj se çfarë diskutuam në pikën pararendëse, besoj që jemi pajtuar, sipas votimit po flas, që ky Kuvend të bënë përpjekje për respektimin e pavarësisë të agjencioneve dhe në këtë rast për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, sidomos pavarësinë financiare. Prandaj, kemi rasti të bëjmë konkretisht një përmirësim të tillë.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar këtë shqetësim të Zyrës së Rregullatorit për Energji, dhe propozimin e këtij Komisioni ne si grup parlamentar e mbështesim në tërësi.

Jo vetëm për këtë vit financiar, por kjo mënyrë e qasjes së këtij Kuvendi, të vazhdohet edhe me agjencionet tjera, sidomos për planin financiar të vitin 2008 duke respektuar edhe Ligjin, në mbështetje të cilit i kemi formuar edhe këto agjenci.

Ne nuk po bëjmë asgjë tjetër, vetëm po e respektojmë Ligjin, të cilin e ka miratuar ky Kuvend. Mirëpo, edhe kjo nuk është e mjaftueshme. Ndoshta së shpejti duhet të rishikohen këto ligje në drejtim të përmirësimit të tyre për të siguruar një pavarësi të këtyre agjencive jo vetëm financiare, por në përgjithësi. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit zoti Kumnova. Fjalën e ka kërkuar deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI – Ju faleminderit zoti kryesues.

Unë kujtoj që rekomandimet dhe propozimi i argumentuar nga kryetari i Komisionit Parlamentar për Buxhet është në pajtim të plotë me rregullat se si duhet të procedohet, prandaj duhet t'i japim përkrahje të plotë. Ndërsa, sa i përket seancës, mëqë u përmend pak më herët mundësia e ndërprerjes, besoj që sugjerimi do të ishte që seanca të vazhdojë se ato dy pikat e tjera nuk do të na i marrin më shumë se sa 10 minuta.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Mirë zoti Rexhepi, fjalën e ka kërkuar deputeti Ibush Jonuzi,

IBUSH JONUZI – Ju faleminderit! I nderuari kryesues, të nderuar deputetë do të jem shumë i shkurtër dhe atë që e thanë të gjithë, s'do ta përsëris, dhe atë në veçanti kryetari i Komisionit për Buxhet.

Neve si Komision FunkSIONAL për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion edhe këtë çështje e kemi shtruar për arsye se e kemi një bashkëpunim shumë të mirë, do të thotë, me Zyrën e Rregullatorit për Energji që edhe më herët u cek.

Pikërisht edhe mungesa e kryerjes së detyrave në këtë zyrë është për shkak të largimit të një numri të madh të stafit punonjës të administratës që gjithsej janë larguar deri tani 9 si dhe lëshimi i një anëtarit të bordit që do thotë se bordi funksionon me katër anëtarë, prandaj ne asgjë s'po bëjmë por vetëm po e zbatojmë Ligjin për Rregullatorin e Energjisë për vitin 2004/8 dhe unë plotësisht e mbështes këtë dhe se duhet të miratohet rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ju faleminderit”

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit zoti Jonuzi. Fjalën e ka kërkuar deputeti Nazim Jashari .

NAZIM JASHARI – Ju faleminderit zoti kryesues, të nderuar kolegë deputetë. Mendoj se kolegu Koci, më së miri e ilustroi mënyrën e vendimmarrjes në Komision lidhur me këtë problematikë që po e trajtojmë. Edhe një herë konstatoj një mënyrë jo të pëlqyer të Kuvendit të Kosovës, ku vendimet merren në mënyrë arbitrare, duke mos respektuar procedurat dhe aktet, sipas të cilave funksionon ky Kuvend. Mendoj se nevoja që Zyra e Rregullatorit të Energjisë të ketë një pavarësi funksionale dhe të ketë një qetësi, një stabilitet funksional, financiar, është nevojë e cila nuk do diskutim, mirëpo vendimet duhet të merren konform rregullativës që kemi në fuqi dhe jo të bëjmë shkelje të rregullave dhe të procedurave, sepse me këtë dëshmojmë që nuk e kemi fort rend as haber lidhur me punën e institucioneve.

Sidoqoftë, mendoj se Zyra e Rregullatorit të Energjisë është një problem në vetë dhe gjitha zyrat apo agjencitë tona rregullatore janë probleme të cilat në njëfarë mënyre, në sistemin shoqëror politik të Kosovës, ky që është, megjithë këto mangësi që i ka, nuk ia ka dalë t'ua sheh hajrin dhe nuk ua ka dalë që t'i asimilojë dhe t'i institucionalizojë në mënyrën më të mirë të mundshme në të mirë të qytetarëve të Kosovës, që u tha edhe më herët gjatë debatit për raportin e Rregullatorit. Mendoj se sa do që ne t'ua rrisim pagat ose t'i krijojmë rrethanat që anëtarët e Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë të kenë paga më të larta, ata do të kenë shumë vështirë të barazohen me paga me KEK-un , me zyrtarët e KEK-ut, ku kemi pasur informacione që zyrtarët e niveleve të mesme kanë paga jashtëzakonisht të mëdha krahasuar edhe me institucionet më përfaqësuese të Kosovës si janë: Kuvendi, Presidenca, apo Kryeministria dhe vijmë te një dilemë tjetër - A mund Kuvendi i Kosovës, në këtë rast Komisioni i Buxhetit që me këso zgjidhjesh ad-hoc të krijojë balans funksional mes institucioneve në Kosovë apo duhet që kjo shoqëri të ulët dhe ta sheh një herë mirë analizën. Ta bëjë një analizë të pagave dhe të mënyrës së shpërndarjes së të mirave shoqërore në këtë vend dhe duke notuar një ndarje të re të mirave, të cilat realizohen nga monopolet publike,, të përpiket ta ndërtojë një balancë të ri funksional për këtë shoqëri. Sa do që do të rritet paga edhe me këto sa janë kërkuar 45. mijë euro të këtyre zyrtarëve të ZRE-së ,gjithmonë, do të gjenden ata të tillë që do të ikin nga ZRE-ja , sepse në KEK janë pagat shumë më të larta dhe meqenëse ata përgjegjësish janë njerëzit ,të cilët kanë ardhur nga KEK-u në ZRE, ata e kanë lënë vendin e vet atje dhe kthehen gjithmonë ,sepse njerëzit, tek e fundit është njerëzore, vrapojnë pas pagave më të mira.

Mendoj se problemi themelor, po e theksoj edhe një herë në Kosovë është KEK-u dhe jo pagat e ZRE-së .Me këto paga që realizon KEK-u , duke punuar me humbje maksimale, ai vetëm e destabilizon sistemin ekonomik të Kosovës. Një herë më herët në këtë foltore

e kam quajtur Kosovën e kam krahasuar me një aeroplan, i cili e ka një vrimë dhe ajo vrimë është

KEK-u. Pa e mbyllur atë vrimë, Kosova e ka të vështirë të ndërtojë një sistem ekonomik të qëndrueshëm. Prandaj, unë nuk jam për zgjidhje ad-hoc, jam që proceduralisht të përcillen të gjitha zgjidhet dhe të bëhet një zgjidhje sistemime, sigurisht duke negociuar Komisioni i Buxhetit me Qeverinë, sepse Qeveria i ka paratë, Qeveria i harxhon mjetet, kurse Komisioni i Buxhetit do të duhej të ishte në këtë rast avokat i ZRE-së dhe jo të marrë vendime Kuvendi për ndarjen e mjeteve, sepse është një praktikë e cila në botë nuk praktikohet. Ju faleminderit!.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit zoti Jashari. Unë po shoh emra që po përsëriten. Nëse mendojnë të bëjnë replika dhe i shohim të domosdoshme, do t'ua jap fjalën nga një minutë dhe jo më shumë. Për të njëjtin problem, nuk bisedohet dy herë, pos replike. Urdhëro Naser Osmani.

NASER OSMANI – Unë kam vetëm qëllimin të jap një sqarim: Nuk është fjala për rritjen e buxhetit për mjete të reja, por është fjala për bartje të mjeteve nga një pozicion, nga pozicioni i mallrave dhe shërbimeve që kanë qenë mjete të destinuara për shpërbllimin e shërbimeve intelektuale në kategorinë e pagave dhe mëditjeve. Kjo është çështja.

Sa i përket anës tjetër, më 31.7 nuk ka pasur forum se njerëzit kanë qenë nëpër deti. Këta që po flasin, kolegët e mi, kam biseduar me ta dhe kam marrë pëlqimin se me 23 është shfuqizuar dhe është botuar në Komision që nuk kanë qenë të pranishëm asnjëri që po fol, kjo është ajo desha të them..

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit, Gani Koci. Gani -replikë. Një minutë e ke, më shumë jo.

GANI KOCI –Zoti kryetar, më 12 qershor kemi shqyrtuar raportin financiar të kësaj zyre dhe aty u shtruar çështja e mungesës, ose e buxhetit të limituar dhe i interesit që të bëhet një bartje në rishqyrtimin gjashtë mujorë të buxhetit. Në parim, kjo kërkesë e tyre është miratuar është pëlqyer dhe është kërkuar që të vazhdohet në procedura dhe të bëhet kërkesë. Kur është bërë kërkesa, me datën 18. 7 është dashur të shqyrtohet më 23 të shtatit që nuk është shqyrtuar kjo si kërkesë edhe atëherë, për shkak të kuorumit. Unë kam qenë në atë mbledhje të 24 korrikut.

Më 31 korrik është thirrur mbledhja dhe vendimi thotë se u mor më 31 korrik nuk është e vërtetë. Unë kërkoj të respektohen procedurat dhe të bëhet kjo ndarje. Këtu ka edhe një shkelje tjetër procedurash,

SABRI HAMITI –Hajt, grahni më shpejt.

GANI KOCI – Prit se po duhet t'ia interpretoj nenet dhe ligjet, të lutem. Ligji për financat publike, menaxhimin e financave publike tregon qartë, neni 27 se kur dhe si bëhet transferimi i mjeteve nga një linjë buxhetore në një linjë tjetër buxhetore. As kjo nuk është respektuar, ju lutem.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Kolegë nuk e ke fjalën, pa e marrë fjalën mos flisni.! Le të më lejohet një shpjegim i vogël. Mos u tregoni histori të procedurave anëtarët e të njëjtit komision. Kjo është sipas procedurave, çdo gjë është në rregull. Kryesia e

Kuvendit ka pasur arsyet dhe argumentet që i ka nxjerrë në Kuvend dhe është seanca ,që fundi i fundi, vendos për çdo gjë.

Më në fund, ju të gjithë po thoni që është e arsyeshme dhe po humb një kohë me problemet e tjera. Fjalën e ka Ali Sadrija.

ALI SADRIJA – Po flas si deputet .Normalisht më vjen mirë që kolegët thirren në ligj, por nuk e lexojnë ligjin. Le të urdhërojë ta lexojë ligjin dhe do të shoh se nuk ka kurrfarë shkelje të procedurave. Në ligj, nuk funksionon dhe nuk përmendet as Komisioni i Buxhetit, as Kryesia e Kuvendit. Janë procedurat se si bëhet bartja e mjeteve prej një destinimi në destinim tjetër. Unë, nga materiali që kam përpara dhe siç e keni të gjithë ju , është propozimi i organit rregullativ dhe është Kuvendi i cili vlerëson arsyen e bartjes së atyre mjeteve. Unë po shoh se të gjithë arsyen po e pranoni, por po thirreni në do procedura dhe po ju them se ligji nuk ka procedura të asaj natyre çfarë e shpjeguan dy kolegët e mi. Nëse doni unë po ua citoj.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit. Fjalën e ka Rifat Krasniç

RIFAT KRASNIÇ- Ju faleminderit zoti kryesues. Edhe unë në emër të Grupit Parlamentar 6+ dhe në emër të Komisionit për Buxhet e përkrah propozimin me rekomandim për bartjen e mjeteve buxhetore të Zyrës Rregullatore të Energjisë. Asgjë tjetër, ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Atëherë, ju thërras të bëheni gati që të votoni për rekomandimin rreth këtyre bartjeve të mjeteve. E lus teknikën të dhe deputetë të jenë gati për votim. Në sallë janë 69 deputetë. Ju lutem votojmë tash:

Për..... 50,

Kundër..... 18.

Edhe dy vota, që ju me dorë i bëni, bëjnë 52 - për. Ju lutem shumë, të merreni vesh. Këtu pat ide se janë edhe dy pika që mendohet që kalojnë shpejtë. A jeni që t'i kaloni këto dy pika apo të shkojmë në drekë të merremi vesh të gjithë. A jeni të vazhdojmë apo të shkojmë?

Atëherë, të kalojmë në pikën numër 8:

- Shqyrtimi i Projektrezolutës për Trepçën, të propozuar nga Komisioni,për Tregti, Industri, Miniera, Transport dhe Telekomunikacion.

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Miniera, Transport dhe Telekomunikacion, në pajtim me rregullën 32 të Rregullores së punës ka hartuar dhe Kuvendit ia ka propozuar tekstin e Projektrezolutës për Trepçën. Teksti i Projektrezolutës i është shpërndarë deputetëve.

Unë kërkoj, sipas radhës dhe rendit, propozuesi i kësaj rezolute ta marrë fjalën, e ky është kryetari i Komisionit për Ekonomi,Tregti, Energjetikë, zoti Ibush Jonuzi.

IBUSH JONUZI – Ju faleminderit. I nderuari kryesues, deputetë të respektuar dhe ju të pranishëm. Dola për dy arsye këtu. Arsyeja e parë është se tani është 80- vjetori i punës, do të thotë të minierave të Trepçës nën 1. Nën 2. kemi të bëjmë me një shtresë, apo më

mirë të them me një Trepçë që është pasuri kombëtare. Duke pasur parasysh rëndësinë që ka Trepça dhe ka pasur edhe në të kaluarën, Komisioni FunkSIONAL vazhdimisht ka qenë i preokupuar a thua çka po ngjet me Trepçën? Radhazi nuk kemi heshtur asnjëherë, vetëm kohëpaskohe e kemi shtruar si çështje me prioritet në Komisionin FunkSIONAL. Në vitin e kaluar, pikërisht më 10 tetor të vitit 2006 ne e kemi thirrur një mbledhje të Komisionit me të vetmin rend të ditës- çështja e Trepçës. Kanë marrë përfaqësuesit e Trepçës dhe përfaqësuesit e AKM-së. Si përfundim i mbledhjes ka dalë se tani është vlerësuar në të gjitha ekspertizat profesionale, si ato prej vendorëve dhe ndërkombëtarëve se Trepça mund të punojë me rezultate pozitive, që është pa dyshim. Nën një. Dhe, nën 2, nga përfaqësuesja e AKM-së është thënë se nuk do të bëhet privatizimi i Trepçës derisa të definohet statusi përfundimtar i Kosovës, për çka Komisioni FunkSIONAL plotësisht e ka mbështetur këtë.. Pastaj , dëgjoheshin kohë pas koha zëra se është duke u punuar në kanale pak pas perdes që thuhet për çështje të Trepçës. Në prill të këtij viti kemi thirrur përsëri AKM-në dhe anëtarët e bordit të AKM-së që janë nga Qeveria jonë se ku do të jetë Trepça? Pa e zgjatur edhe atë është thënë se gjatë fazës së privatizimit, meqë Trepça është me interes të veçantë, do t'i kushtohet edhe theks i veçantë, por qasja ndaj Trepçës do të ketë një qasje krejt tjetër në krahasim me ndërmarrje tjera. Pse? U tha edhe më herët e thuhet gjithmonë Trepça është një pasuri kombëtare. Çdo respekt për të gjitha ndërmarrjet në të kaluarën dhe tani, por nuk është Trepça një kooperativë bujqësore as një ndërmarrje ndërtimore por, si e ka pas thënë ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në 2001- prapë Trepça është Trepçë.

Shqetësimi i Komisionit FunkSIONAL ka arritur kulminacionin ,atëherë kur jemi marrë vesh ,më mirë kemi marrë informata se Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do të emërojë një administrator i cili ka për detyrë riorganizimi dhe privatizimin e Trepçës në bazë të Rregullores 2005/49, rregullore e cila jep gjitha kompetencat atij administratori, pa pasur qasje as Qeveria e as Kuvendi. Prandaj, kjo e ka shtyrë Komisionin FunkSIONAL që të jetë shumë më aktiv në këtë çështje dhe me 26 të muajit të kaluar ,do të thotë korrik ,Komisioni ka thirrur mbledhje me të vetmen pikë të rendit të ditës- çështja e Trepçës . Kemi thirrur prej kryeministrit që ka qenë përfaqësuesi më mirë të thuhet këshilltari i kryeministrit, Ministrinë j për Energjetikë dhe Miniera, Ministrinë për Ekonomi dhe Financa, Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe komplet Komisioni.

Me një fjalë, strukturat që kanë qasje në çështje të Trepçës. Pas një debati të gjerë është ardhur deri te ajo që duhet të kihet kujdes dhe duhet të hartohet një draft rezolutë për çështje të Trepçës.

Më 31 të muajit të kaluar, do të thotë korrik, Komisioni FunkSIONAL e ka hartuar draft rezolutën për Trepçën që e keni gjithë para jush, që nuk dua të komentoj.

Pas kësaj kohe kanë pasuar presionet dhe reagimet prej të gjitha niveleve ,duke filluar prej AKM-së, Shtyllës së IV të UNMIK-ut, Përfaqësuesit Special, të Sekretarit të Përgjithshëm , USAI-dit amerikan dhe z Zyrës amerikane, duke u thirrur në Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Komisioni FunkSIONAL edhe në mbledhjen e rregullt të datës 24 e ka shtruar këtë çështje dhe është informuar me ngritjen e tensioneve rreth hartimit të kësaj rezolute. Pas një takimi që e kemi pasur bashkërisht të thirrur nga Përfaqësuesit Special, ka qenë kryetari i Kuvendit, kryetari i Qeverisë, ministri i Energjetikës dhe Minierave, ministri për Tregti

dhe Industri, ministri për Buxhet dhe Financa, respektivisht përfaqësuesi i tij, është kërkuar nga Komisioni që për një kohë të heqë dorë ,më mirë të thuhet të pauzojë kërkesën e vet për nxjerrjen e një rezolute.

Kërkesë e veçantë nëpërmjet dy përfaqësuesve të USAID-it amerikan që është thënë se kemi ardhur në emër të Zyrës Amerikane dhe në emër të Qeverisë amerikane që të shikohet se çfarë është kjo çështje . Në fund ka dalë se krejt ka qenë informim i gabueshëm, sepse nuk është qëllimi i Komisionit dhe i Kuvendit që ajo që është trumbetuar jashtë, por të ruhet Trepça si Trepçë dhe të mos lejohet që të caktohet një administrator për privatizime dhe organizimin e Trepçës në kushte që nuk ka qasje Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës dhe është kërkuar prej tyre ne të japim një afat shtesë prej 2 javësh që të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores 2005/48 që të kenë qasje institucionet vendore, do të thotë Qeveria dhe Kuvendi e pastaj të miratohet Rezoluta në fjalë. Sot është ulur Komisioni dhe pas këtyre kërkesave që i thashë më herët të gjithëve, Komisioni pajtohet që të shtyhet miratimi i Rezolutës për 2 javë, por Kuvendi, në emër të Komisionit e them, të votoj sot që pas 2 jave të hyjë në seancë pa procedurë dhe të votohet rezoluta në fjalë. Është thënë edhe prej përfaqësuesve të USAID-it amerikanë nëse nuk bëhet ndryshimi brenda dy javë ditëve, atëherë është plotësisht e drejtë juaja që të miratoni Rezolutën në fjalë. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit zoti referues. Unë u përpoqa të dëgjoj shumë kujdesshëm një histori gati epike që e tregoi shefi i këtij Komisioni çfarë idesh kanë pasur dhe qysh janë mbrapsur, pak a shumë edhe me shenja për pa arsyetime. Unë kërkoj së dyti, sepse ne jemi në Kuvend .ne kemi obligime ndaj pikave që i kemi në rend dite. Kërkoj në mënyrë të disiplinuar dhe të saktë çka po do Komisioni tash? A po do ta heqë prej rendit të ditës apo çka po do, sepse unë dua ta qesë në votim. Në emër të Komisionit kushdo qoftë, por ne duam qartësi çfarë donë Komisioni- a të votohet sot për këtë pikë të rendit të ditës apo kërkon ta heqim prej rendit të ditës?

Ibush Jonuzi, edhe një herë paraqitet për fjalë.

IBUSH JONUZI – Profesor i nderuar dhe deputetë të pranishëm.

Kërkoj falje nëse nuk kam qenë i qartë. Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar edhe sot dhe pas atyre kërkesave që i ceka kërkon që të shtyhet për 2 javë ditë miratimi i Rezolutës. Pas 2 javë dite ,do të thotë, të shtrohet në seancë plenare miratimi i Rezolutës në fjalë.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Prapë nuk je i qartë! Kjo është procedurë parlamentare. A doni të votohet sot, a jo? A bëhet pas dy jave a 2 vjete, nuk është problem që vendoset sot. Unë ju lus shumë - a doni që të votohet Rezoluta sot apo ndoshta Komisioni kërkon që kjo sot të mos votohet, do të thotë të shtyhet.

IBUSH JONUZI – Na kërkojmë që të mos votohet sot, profesor, të shtyhet.

KRYESUESI SABRI HAMITI – E po, mirë pra, atëherë unë e vë në votim kërkesën e Komisionit gjegjëse që sot të mos votohet as për as kundër propozimit të Rezolutës, por që kjo të shtyhet dhe shqyrtohet pas dy javësh.

Bëhuni gati të votojmë. Lus teknikën të vazhdojmë votimin dhe votojmë tash.

Kush është për?

Kemi 68 të pranishëm.

45 janë për propozimin e ri të Komisionit, 13 janë kundër edhe 2 votojnë me dorë. Për çka jeni ju? A jeni për propozim të Komisionit. Në rregull.

Për -----47;
Kundër ----13.

Miratohet propozimi i Komisionit, i riu, që është paraqitur në seancë.

Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës.

- Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me propozimin e Prokurorisë Publike të Kosovës për emërimin e një anëtari në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Prokuroria Publike e Kosovës, në pajtim me vendimin e Kuvendit, ka propozuar një kandidat tjetër për anëtar të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, pas shqyrtimit të propozimit të Prokurorisë Publike të Kosovës, vendosi që Kuvendit t'i rekomandojë emrin e zotit Vesel Jashari për anëtar të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Rekomandimi i Komisionit, bashkë me biografinë e kandidatit, iu është shpërndarë deputetëve.

Ftoj nënkryetarin e komisionit raportues, zotin Sadudin Berisha, që të japë ndonjë shpjegim të shkurtër, nëse e sheh të nevojshme. Sadudin, shkurt, thash - nëse ka nevojë.

SADUDIN BERISHA – Faleminderit, zoti kryesues! Ky rekomandim është dashur të shqyrtohet dhe të miratohet në seancën e fundit të muajit të shkuar, por nuk është bërë. Sot është paraqitur sërish në rend të ditës. E dimë se Kuvendi i Kosovës, në njërën nga seancat e shkuara ka zgjedhur numrin më të madh të anëtarëve të Këshillit Drejtues. Vetëm Prokuroria Publike, sipas Ligjit në fuqi, nuk e ka pasur kandidatin shtesë, për shkak të refuzimit të një kandidature, andaj është përcjellë kandidatura e tij. Komisioni e mbështet kandidaturën dhe i rekomandon Komisionit ta miratojë. Faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit!

Bëhuni gati të votojmë për propozimin. Teknika, bëhuni gati!

Votojmë tash:

Në sallë janë 70 deputetë.

Për..... 53, plus 2 me ngritje dore – 55.
Kundër..... 12.

Konstatohet se u votua ky kandidat për funksionin e paraparë.

Seanca e sotme mbaron me kaq. Mirë u pafshim në seanca të tjera!

(Seanca mori fund në orën 14:30)